

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 87-të i botimit
Mars 2019/ Nr. 3

Ministrja Xhaçka në Bruksel
Ministeriali i Ministrave të
Mbrojtjes të vendeve të NATO-s

FA: Nisin orët e hapura
Ministrja Xhaçka: Mundësi e
jashtëzakonshme për karrierë

Ministrja Xhaçka në Shkup:

**Xhaçka-Shekerinska: Maqedonia e Veriut
në NATO, siguri edhe për rajonin**

Përmbajtja

Numri 3

BAZA E NATO-S NË KUÇOVË

- 15** Nivel i shkëlqyer i bashkëpunimit ushtarak SHBA-Shqipëri

XHAÇKA: PUNA DHE PËRKUSHTIMI SHPËRBLEHEN

- 17** Gjeneral brigade Albert Mullai emërohet komandant i Forcës Tokësore

10-VJET NË NATO

- 22** Flota Detare ngre flamurin e NATO-s në Kalanë e Skënderbeut

7-VJETORI I RËNIES NË KRYE TË DETYRËS

- 34** Përkujtohet Dëshmori i Atdheut kapiten Feti Vogli

MINISTERIALI I NATO-S: BRUKSEL

- 44** Stoltenberg: NATO nuk do garë armatimesh

STAFI

DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA
Saimir ALIJA

Redaktore korrektore:

Anila DODA

Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ



4 MINISTRJA XHAÇKA NË SHKUP:

Xhaçka-Shekerinska: Maqedonia e Veriut në NATO, siguri edhe për rajonin

Anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO garanton një rajon më të sigurt. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka u shprehu urimet e Shqipërisë...



11 143 REKRUTË DREJT BUNAVISË

Xhaçka: Hapja e Forcave të Armatosura për vajzat, një domosdoshmëri

143 djem e vajza u nisën ditën e hënë, më 18 shkurt, për në Shkollën e Trupës në Bunavi, ku për rreth tre muaj do t'i nënshtrohen Stërvtjes Individuale Bazë, përpara se të betohen...



13 FA: NISIN ORËT E HAPURA

Ministria Xhaçka: Mundësi e jashtëzakonshme për karrierë

Forcat e Armatosura dhe mundësitë për të bërë karrierë në to, do të jenë më në vëmendje të rinjve shqiptarë. Ministria e Mbrojtjes nisi ditën e premte, më 22 shkurt 2019, nga Fieri fushatën e orëve të hapura...



47 ME RASTIN E 575 VJETORIT

Kuvendi i Lezhës, ngjarje madhore në historinë kombëtare shqiptare

Lufta e madhe shqiptaro-osmane nën udhëheqjen e Skënderbeut shpejtoi zhvillimin e një procesi të ligjshëm dhe shumë të rëndësishëm, sikurse ishte bashkimi...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 87-të i botimit
Nr. 3/ 2019

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfutimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni “Skënderbej”

Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





MINISTRJA XHAÇKA NË SHKUP:

Xhaçka-Shekerinska: Maqedonia e Veriut në NATO, siguri edhe për rajonin



Anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO garanton një rajon më të sigurt. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka u shprehu urimet e Shqipërisë drejtuesve më të lartë të shtetit më të ri të Aleancës së Atlantikut të Veriut, gjatë një vizite zyrtare ditën e hënë, më 25 shkurt 2019, në Shkup.

“Nënshkrimi i Protokollit të Anëtarësimit në NATO nga Republika e Maqedonisë së Veriut është vërtet një moment i jashtëzakonshëm për të gjithë ne. Nga sot, i gjithë rajoni do të jetë më i sigurt, me më shumë stabilitet dhe unë jam e bindur, që të gjithë së bashku mund të shohim drejt së ardhmes me më shumë optimizëm”, u shpreh ministria Xhaçka, gjatë Konferencës së Përbashkët me homologen Radmilla Shekerinska. Ministria Xhaçka foli në deklaratën e saj edhe për kërcënime që më së shumti shteteve po u vijnë nga brenda tyre. “Siç na tregoi edhe kalvari i vështirë që përjetoj Maqedonia e Veriut gjatë viteve të fundit, shpesh kërcënimet më të mëdha me të cilat na duhet të përballlemi në punën tonë, nuk janë ato të jashtme, por ato që vijnë nga brenda. Sepse fatkeqësisht, siç ndodhi në Maqedoninë e Veriut, e siç po ndodh sot në Shqipëri, në vendet tona ka jo rrallë forca që për interesat e tyre të ngushta, që s’kanë asgjë të përbashkët me interesat e qytetarëve apo vendeve tona, janë gati të rrezikojnë edhe stabilitetin, edhe zhvillimin, edhe të ardhmen tonë evropiane”, u shpreh më tej ministria Xhaçka.

Ministria e Mbrojtjes theksoi më tej: “Unë jam besimplotë, që për aq kohë sa shumica e qytetarëve të vendeve tona besojnë tek ideali euroatlantik dhe tek ato dëshira

e ëndrra që përmenda më lart, rruga jonë drejt Evropës, një rrugë që kalon përmes modernizimit të vendeve tona, e mbi të gjitha përmes vendosjes së sundimit të ligjit e drejtësisë, është e pandalshme dhe këto forca janë të destinuara të dështojnë. Ashtu siç ndodhi në Maqedoninë e Veriut e ashtu siç do të ndodhë edhe në Shqipëri”. Gjithashtu ndër të tjera ministria e Mbrojtjes Xhaçka ka deklaruar se ndihet mirë që faktori shqiptar, politik dhe qytetar, luajti një rol aq konstruktiv, duke u kthyer në një nga promotorët e këtyre zhvillimeve.

Ndërsa ministria e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut, Radmilla Shekerinska, theksoi se Shqipëria çdo herë ka mbështetur Maqedoninë dhe se kjo mbështetje nuk do të harrohet. Ajo nënvizoi edhe aktivitetet ku dy vendet do të bashkëpunojnë si aleate. “Pjesëtarët e Armatës sonë do të jenë pjesë e ushtrimit multinacional që do të mbahet këtë vit tek fqinjët tonë, ndërsa këtë vit po ashtu me arsye dhe argumente plotësuese do të marrim pjesë në iniciativën Bashkëpunimi i Adriatikut-SHBA të cilën do ta kryesojë pikërisht Republika e Shqipërisë”, deklaroi Radmilla Shekerinska, Ministre e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut. Ministria Shekerinska, uroi Ministren Xhaçka për 10 vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO.

Gjatë vizitës zyrtare në Shkup, Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka u prit edhe nga kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev dhe kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferri. Ministria Xhaçka është ministria e parë e vendeve të NATO që viziton Maqedoninë pas nënshkrimit të Protokollit të Pranimit në Aleancën e Atlantikut të Veriut.

Gjatë vizitës në Shkup, Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka u takua edhe me Kryeministrin Zoran Zaev dhe kryetarin e Kuvendit, Talat Xhaferri.



Olta Xhaçka Zoran Zaev

Integrimi në NATO do të thotë paqe dhe stabilitet

Ministrja e
Mbrojtjes
Olta Xhaçka,
u prit nga
kryeministri i
Maqedonisë
së Veriut,
Zoran Zaev

Gjatë vizitës në Maqedoninë e Veriut, Ministrja e Mbrojtjes, znj. Olta Xhaçka, u takua me kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, z. Zoran Zaev. Në takim është përshëndetur udhëheqësia e përgjegjshme e Kryeministrit Zaev, që mundësoi arritjen e marrëveshjes me fqinjin jugor Greqinë dhe realizimin e Marrëveshjes së Prespës. Është vlerësuar se Marrëveshja është shembull se si zgjidhen çështjet dypalëshe, përderisa ekziston vullnet politik i sigurtë, me çka Marrëveshja e Prespës është përfitim si për Maqedoninë e Veriut, por ashtu edhe për rajonin. Gjithashtu në, takim u shpreh mbështetje nga Republika e Shqipërisë për antarësimin Maqedonisë së Veriut në NATO, ku kryeministrin Zaev ka falenderuar Kuvendin, kryeministrin Edi

Rama dhe qeverinë shqiptare, por edhe qytetarët shqiptarë për integrimin e Maqedonisë së Veriut në NATO. "Integrimi në NATO do të thotë paqe dhe stabilitet, por dhe ekonomi më të mirë për qytetarët tanë. Tani është rritur numri i investitorëve të cilët investojnë ose kanë paralajmëruar që do të investojnë në vendin tonë. Ky është një përfitim i madh për cilësinë e jetesës të qytetarëve tanë, pas politikave për fqinjësi të mirë, ku ne mbyllëm çështjet e hapura prej dekatash me fqinjët tanë, si dhe koncepti ynë integruar, për një shoqëri për të gjithë qytetarët", tha Kryeministri Zaev.

U konkludua se të dyja vendet, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Shqipërisë, me miqësinë e tyre të sigurtë, krijojnë kushte për zhvillim e bashkëpunim dhe kjo ndikon pozitivisht në aspiratat dhe prirjet evropiane të të dyja shteteve tona dhe rajonit. "Në rast se e rrisim bashkëpunimin në mes shteteve të Ballkanit Perëndimor, respekti i Bashkimit Evropian ndaj nesh, do të jetë më i madh", tha Kryeministri Zaev. Gjatë takimit me ministren Xhaçka, kryeministri Zaev theksosi edhe rritjen e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe tha se "shteti ynë është i përgatitur dhe po ndjek përvojat pozitive për investime në Armatë sipas standardeve të NATO-s". Ai informoi se vijojnë reformat në shumë fusha, sidomos ato në sektorin e sigurisë të cilat realizohen në bashkëpunim me vendet anëtare në NATO.

Në takim janë theksuar mundësitë që ekzistojnë për rritjen e bashkëpunimit në mes dy shteteve në fusha të tilla si: lidhjet infrastrukturore, energjetike, etj.





Olta Xhaçka-Talat Xhaferi

Stabiliteti i Ballkanit do të thotë siguri për vendet e Evropës

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka takohet kryeparlamentarin Talat Xhaferi

Mbrojtja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, u takua në Shkup më 25 shkurt, me Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Talat Xhaferi. Në takim, të dy bashkëbiseduesit shprehën kënaqësi për ratifikimin nga ana e Parlamentit shqiptar, të Protokollit për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO. U theksua bashkëpunimi i shkëlqyer ndërmjet Tiranës dhe Shkupit, si edhe përpjekjet e Shqipërisë për mbështetjen e Maqedonisë së Veriut në rrugën e zhvillimit evropian. Kryetari Xhaferi theksoi se Republika e Maqedonisë së Veriut është në rrugën e sigurt kah NATO-ja ndërsa shteti punon me përkushtim në përmbushjen e reformave të domosdoshme për marrjen e datës për fillimin e negociatave me BE-në. "Jemi të vetëdijshëm se ky

“Jemi të vetëdijshëm se ky proces nuk është i lehtë, por Kuvendi dhe Qeveria punojnë me të gjitha forcat dhe kapacitetet për arritjen e qëllimit të dëshiruar”.

proces nuk është i lehtë, por Kuvendi dhe Qeveria punojnë me të gjitha forcat dhe kapacitetet për arritjen e qëllimit të dëshiruar”, tha Kryetari Xhaferi. Ai e potencoi domosdoshmërinë e bashkëpunimit në të gjithë komponentët politikë për përmbushjen e obligimeve për të mirën e qytetarëve dhe të shtetit. Ministrja Xhaçka, shprehu urimet e saj për hapat e guximshme politike për deblokimin e procesit të integriteteve euroatlantike. Ajo theksoi mbështetjen e fuqishme të Shqipërisë për proceset reformuese nga agjenda jonë e BE-së

dhe ofroi këmbim të përvojave në aspektin bilateral për përforcimin e kapaciteteve. Ajo theksoi se qëllimi final duhet të jenë perspektiva euroatlantike, duke e mbështetur njëri tjetrin. Të dy bashkëbiseduesit thanë se stabiliteti i vendeve të Ballkanit do të thotë siguri për vendet e Evropës. Kryetari Xhaferi shprehu falënderime të sinqerta për mbështetjen e vazhdueshme të Shqipërisë për aspiratat integruese në institucionet euroatlantike me shpresë se bashkëpunimi i frytshëm do të vazhdojë edhe në të ardhmen.



Ministrja Xhaçka në Bruksel

Ministeriali i Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të NATO-s

Ministrja e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut, Radmilla Shekerinska falenderoi Shqipërinë për ratifikimin e Protokollit të Anëtarësimit në Aleancë

Më datat 13 dhe 14 shkurt 2019 është zhvilluar në Bruksel, Ministeriali i Ministrave të Mbrojtjes të 29 vendeve antare të NATO-s. Në Ministerialin e drejtuar nga Jens Stoltenberg, Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s, ishin të pranishëm Sekretari Amerikan i Mbrojtjes Patrick Shanahan; Ministri i Mbrojtjes i Britanisë së Madhe zoti Gavin Uilliamson; Ministrja e Mbrojtjes e Gjermanisë, zonja Ursula von der Leyen; Ministrja e Mbrojtjes e Francës, zonja Florans Parli; Ministri i Mbrojtjes i Kanadasë, zoti Harjit Sajjan; Ministri i Mbrojtjes i Italisë, zonja Elizabeta Trenta; Ministri i Mbrojtjes i Greqisë, zoti Evangelos Apostolakis; Ministri i Mbrojtjes i Turqisë, zoti Hulusi Akar, etj. Në Ministerialin e Ministrave të Mbrojtjes, pala shqiptare përfaqësohej nga Ministrja e Mbrojtjes, zonja Olta Xhaçka. Me statusin e "Të ftuarit" në Ministerial mori pjesë për here të parë edhe Maqedonia e Veriut e përfaqësuar nga Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska. Ministrja Shekerinska falenderoi Shqipërinë për ratifikimin e Protokollit të Anëtarësimit në Aleancë.

Gjatë zhvillimit të Ministerialit ministrja Olta Xhaçka është takuar me

zonjën Ursula von der Leyen, Ministre e Mbrojtjes e Gjermanisë, zonjën Elisabeta Trenta, Ministre e Mbrojtjes e Italisë, zotin Evangelos Apostolakis, Ministër i Mbrojtjes i Greqisë, etj.

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, në emër të Qeverisë Shqiptare shprehu vendosmërinë për të vijuar kontributin në gjithë misionet e NATO, si dhe konfirmoi angazhimin për të rritur buxhetin e Mbrojtjes në 2% të PBB, deri në vitin 2024. Këto angazhime u vlerësuan nga ministrat e Mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO.

Ministrat e Mbrojtjes të NATO kanë diskutuar hapat që kërkohen për të mbrojtur Europën nëse Intermediate Range Nuclear Forces Treaty, një traktat dypalësh amerikano-rus për çarmatimin, do të dështojë. Traktati ndalon raketat bërthamore me një distancë prej 500 deri në 5.500 kilometrash. Njëherësh ky traktat përbën themelin e arkitekturës së sigurisë të Europës pas firmosjes 32 vite më parë. Vendet anëtare të Aleancës ndanë qëndrim të njëjtë pro-mbështetës për aleatin tonë strategjik, SHBA, mbi shkeljet e vazhdueshme nga Rusia të INF - Treaty (Traktatit të Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme Veprimi).

Ministrat kanë diskutuar përpjekjet për të forcuar parandalimin dhe mbrojtjen e Aleancës, shqyrtimin e misioneve të NATO-s në Afganistan, Kosovë, Irak dhe në zonën detare. Bashkëpunimi i ndarjes së ngarkesës dhe bashkëpunimi NATO-BE ishin gjithashtu në rend të ditës.

Lidhur me Kosovën dhe praninë e Forcës së Sigurisë së Kosovës në veri, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, z. Stoltenberg tha se: "Kemi një marrëveshje, Marrëveshjen e Brukselit nga 2013 duke deklaruar qartë se Forcat e Sigurisë së Kosovës nuk mund të shkojnë në veri pa pajtimin e komandantit të KFOR-it, COMKFOR-it. Kjo marrëveshje është ende e vlefshme, ende zbatohet. NATO do të mbetet në Kosovë me KFOR-in, sepse KFOR-i bazohet në mandatin e OKB-së. Dhe prania e KFOR-it është dhe ka qenë e rëndësishme për stabilitetin në Kosovë dhe në të gjithë rajonin. Ajo që ne po vlerësojmë është prania jonë, aktivitetet tona jashtë misionit të KFOR-it. Ne kemi lloje të ndryshme të mbështetjes për ndërtimin e kapaciteteve për Forcat e Sigurisë së Kosovës, të cilat nuk janë pjesë e misionit të KFOR-it, por janë aktivitete të NATO-s jashtë saj".

Ambasadorët e 29 vendeve anëtare të NATO kanë nënshkruar të mërkurën më 6 shkurt 2019, në selinë e NATO-s në Bruksel, Protokollin për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO. Firmosja e Protokollit për Anëtarësimin e Maqedonisë në NATO është bërë në prani të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, z. Jens Stoltenberg dhe Ministrit të Jashtëm të Maqedonise së Veriut, z. Nikola Dimitrov. Secili shtet anëtarë i NATO-së veç e veç nënshkruan Protokollin, ndërsa shteti i parë që nënshkroi ishte Republika e Shqipërisë. Në emër të qeverisë të Republikës së Shqipërisë, Protokollin i Anëtarësimin të Maqedonisë në NATO është firmosur nga z. Visho Ajazi, ambasador i Shqipërisë në NATO. Protokollin që u firmos dje në Bruksel, duhet të ratifikohet nga Parlamentet përkatëse të 29 vendeve antare të NATO-s. Me këtë rast sekretari gjeneral i NATO-së Jens Stoltenberg deklaroi se ky është një moment historik për vendin dhe se kryeministrat Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras kanë treguar guxim të madh me arrijtjen e Marrëveshjes së Prespës, me çka kanë dhënë kontribut të madh të stabilitetit dhe sigurisë e rajonit. Nga ana tjetër, Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës Atlan-

Firmoset nga 29 ambasadorë Protokollin i Anëtarësimin

Visho Ajazi firmos në emër të Shqipërisë, Maqedonia në NATO



tike të Veriut, Jens Stoltenberg ka kërkuar para pak ditësh nga 29 vendet anëtarë të nënshkruajnë protokollin e anëtarësimin. Stoltenberg,

tha se pasi 29 vendet të ratifikojnë protokollin, do të mund t'i urojnë Maqedonisë së Veriut mirëseardhje si anëtarja e 30-të.

MINISTRJA XHAÇKA:

Urime Maqedonisë për këtë arritje të merituar

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka e ka cilësuar lajm të shkëlqyer firmosjen e Protokollit për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, në selinë e NATO-s në Bruksel, më 6 shkurt nga 29 vendet antare të Aleancës. "Lajm i shkëlqyer sot. Urime qytetarëve të Maqedonisë së Veriut për këtë arritje të merituar. Aleanca hapi krahët dhe dyert për të mirëpritur anëtarin e vet të 30-të në familjen më të madhe politiko-ushtarake. Një mesazh i fortë strategjik për fqinjët tanë dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor. Prej ditës së sotme rajoni ka fituar më shumë siguri, stabilitet dhe paqe", shkruan Xha-



“Urime qytetarëve të Maqedonisë së Veriut për këtë arritje të merituar. Aleanca hapi krahët dhe dyert për të mirëpritur anëtarin e vet të 30-të në familjen më të madhe politiko-ushtarake”.

çka në facebook. Ndërkohë më 14 shkurt 2019, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka ratifikuar protokollin për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO. Projektligji për

ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut u miratua me 130 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim,



Kodheli në Bruksel:

Shqipëria ndër të parët që ratifikoi protokollin për Maqedoninë e Veriut në NATO

Shqipëria ishte vendi i parë që ratifikoi protokollin e anëtarësimit për Malin e Zi dhe është ndër të parat vende që ka bërë të njëjtën gjë me Maqedoninë e Veriut, duke treguar kështu rëndësinë që ka ky proces për vendin dhe gjithë rajonin. Gjatë dy ditëve, më 18 dhe 19 shkurt, në Bruksel u zhvillua mbledhja e Komisioneve të përbashkëta të Asamblesë Parlamentare të vendeve NATO, ku mori pjesë delegacioni parlamentar nga Kuvendi i Shqipërisë kryesuar nga deputetja dhe ish ministrja e Mbrojtjes, zonja Mimi Kodheli.

Në ditën e saj të parë, mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s të Jens Stoltenberg. Diskutimet u përqendruan kryesisht tek situata gjeopolitike dhe ajo e sigurisë, rritje e buxheteve të mbrojtjes dhe vendimmarrja politike lidhur me vazhdimësinë e misioneve NATO. Z. Stoltenberg vuri në dukje se lidhshëria e SHBA me NATO është një lideri i SHBA mbetet çelësi pasi NATO shënon 70 vjetorin e tij dhe përgatitet për takimin e Liderëve në dhjetor.



Zhvillohet në Bruksel mbledhja e Komisioneve të përbashkëta të Asamblesë Parlamentare të vendeve të NATO-s

Gjatë ndërhyrjes së saj, Kodheli tha se Shqipëria ishte vendi i parë që ratifikoi protokollin e anëtarësimit për Malin e Zi dhe është ndër të parat vende që ka bërë të njëjtën gjë me Maqedoninë e Veriut, duke treguar kështu rëndësinë që ka ky proces për vendin dhe gjithë Rajonin.

“SHBA konfirmon përkushtimin ndaj NATO-s”. Me këto fjalë dhe nën moton “Dialog-Transparencë-Partneritet”, u zhvillua dita e dytë e punimeve të Asamblesë, ku e ftuar e nderit ishte Nancy Pelosi, Kryetare e Kongresit Amerikan. Pelosi rikonfirmoi angazhimin e Shteteve të Bashkuara në Europë dhe rezoluta e mbështetjes për NATO-n e miratuar në Kongresin janar të kaluar, është një

demonstrim i saj. Ajo tha se vetëm dialogu i sinqertë mund të sjellë bashkëpunimin mes vendeve, duke sjellë shembullin e Rusisë. Kryetaria Pelosi duke dhënë shifra, saktësoi se 10% e Kongresit amerikan është i angazhuar në Evropë, duke treguar angazhimin e SHBA-ve në kontinentin e vjetër. Delegacioni parlamentar i SHBA-ve ishte ndër më të përfaqësuarit. Pelosi shoqërohej nga Kryetari i Komisionit për Politikën e Jashtme të Kongresit, Eliot Engel. E ftuar ishte edhe zëvendës presidentja e Komisionit Evropian, Federica Mogherini e cila gjatë prezantimit u ndal tek roli i PESCO dhe e ardhmja në marrëdhëniet mes BE dhe NATO.

143 rekrutë drejt Bunavisë

Xhaçka: Hapja e Forcave të Armatosura për vajzat, një domosdoshmëri

Nisen drejt Shkollës së Trupës në Bunavi 143 rekrutë të rinj nga të cilët 10 janë vajza dhe 18 janë me arsim të lartë.

143 djem e vajza u nisën ditën e hënë, më 18 shkurt, për në

Shkollën e Trupës në Bunavi, ku përrreth tre muaj do t'i nënshtrohen Stërvitjes Individuale Bazë, përpara se të betohen si ushtarët dhe detarët më të rinj të Forcave të Armatosura.

Në ceremoninë e përcjelljes së rekrutëve të rinj ishte e pranishme vetë ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, e cila vlerësoi zgjedhjen e këtyre djemve e vajzave për t'iu bashkuar Forcave të Armatosura.

"Të bëhesh pjesë e Forcave të Armatosura do të thotë të bëhesh pjesë

e një skuadre. Nuk është e lehtë e nuk mund të jetë e lehtë të bëhesh pjesë e Forcave të Armatosura. Aq më shumë sot, kur të bëhesh pjesë e ushtrisë shqiptare, do të thotë të bëhesh pjesë e një aleance si NATO. Do të thotë që nesër pasnesër të shërbesh në misionet e Aleancës krah për krah me aleatët tanë amerikanë, gjermanë, francezë, anglezë. Me ushtarakët e ushtrive më moderne e më profesioniste që njih sot bota", - u shpreh ministrja Xhaçka.

Ajo i kushtoi një vëmendje të veçantë rekrutëve vajza dhe barazisë gjinore në Forcat e Armatosura.

"Të hapësh Forcat e Armatosura për gratë e vajzat shqiptare





143 kandidatët që u përcollën për në Shkollën e Trupës në Bunavi, u përzgjedhën pas testeve fizike, intelektuale dhe psikologjike nga Qendra e Personel Rekrutimit të Forcave të Armatosura. Pjesë e kandidatëve për ushtarë/detarë janë edhe 10 vajza, ndërkohë që 18 rekrutë janë me arsim të lartë.



është një domosdoshmëri! Dhe ne nuk mund të kemi më të mirët, më të talentuarit, më të përkushtuarit, në qoftë se përjashtojmë nga përzgjedhja plot gjysmën e shqiptarëve vetëm sepse janë gra dhe ushtria është vend për burra. Ne kemi nevojë për talentin e çdo djali dhe çdo vajze! Por, jam po ashtu e vetëdijshme, që jemi ende larg hapjes së vërtetë të Forcave të Armatosura si një mundësi reale karriere për çdo vajzë e çdo grua, që dëshiron t'i bashkohet kësaj organizate për t'i shërbyer vendit dhe popullit të saj. Për një organizatë si Forcat e Armatosura të Shqipërisë që sot janë duke përjetuar një proces modernizimi e profesionalizimi sipas standardeve më të larta të NATO, kjo mbetet një sfidë që unë jam shumë besimplotë se mund ta fitojmë", deklaroi ministrja e Mbrojtjes.

143 kandidatët që u përcollën për në Shkollën e Trupës në Bunavi, u përzgjedhën pas testeve fizike, intelektuale dhe psikologjike nga Qendra e Personel Rekrutimit të Forcave të Armatosura. Pjesë e kandidatëve për ushtarë/detarë janë edhe 10 vajza, ndërkohë që 18 rekrutë janë me arsim të lartë.

Ministrja Xhaçka: Mundësi e jashtëzakonshme për karrierë

Forcat e Armatosura ofrojnë arsimim edhe jashtë vendit, bazuar në aftësi në meritokraci

Forcat e Armatosura dhe mundësitë për të bërë karrierë në to, do të jenë më në vëmendje të të rinjve shqiptarë.

Ministria e Mbrojtjes nisi ditën e premte, më 22 shkurt 2019, nga Fieri fushatën e orëve të hapura të mësimi në shkollat e mesme të vendit, me qëllim njohjen e të rinjve me mundësitë që Forcat e Armatosura ofrojnë për t'u punësuar, studiuar dhe shërbyer vendit. Në çeljen e fushatës në shkollën e mesme "Perikli Ikonomi" në Fier, mori pjesë edhe ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, e cila fillimisht vlerësoi punën e Forcave të Armatosura, edhe pse shpeshherë të padukshme. Duke folur për shanset që Forcat e Armatosura ofrojnë për punësimin dhe arsimimin ushtarak, ministrja Xhaçka i ftoi të rinjtë fierakë që janë në fazën e përzgjedhjes së karrierës, të marrin në konsideratë mundësinë për të shërbyer në uniformë.



"Në FA ka profesione nga më të ndryshmet. Nuk ka vetëm ushtarë, por ka edhe profesionistë. Në FA, ka nga të gjithë profesionet, gjë që ndoshta nuk duket, por që ne duam t'ju tregojmë, që ta konsideroni si një mundësi më shumë kur përzgjidhni karrierën tuaj. Në FA, futesh jo vetëm për të bërë ushtarin, por futesh për të marrë një profesion, për të bërë një karrierë të mirëfilltë Brenda FA-ve, edhe si jurist, edhe si ekonomist, edhe si pilot, edhe si mjek profesionit, edhe si infermier dhe çdo profesion tjetër që mund t'ju shkojë ndërmend. Edhe për ata që duan një formim profesional edhe nuk duan të vazhdojnë arsimin e lartë ka vend në FA, mund të bëhesh një xhenier shumë i mirë, mund të bëhesh një teknik shumë i mirë, mund të gjesh një profesion që të shërben që të gjesh një të ardhme të sigurt për veten dhe për familjen tënde.", u shpreh Xhaçka.



kurse funksionale dhe kurse institucionale te cilat janë vërtetë një mundësi e jashtëzakonshme për të arsimuar dhe për të trajnuar dikë që t'i bëjë ballë jetës edhe karrierës përmes një profesioni të mirëfilltë. Dhe FA-të e ofrojnë këtë mundësi.”

Ora e hapur e mësimit në shkollën e mesme “Perikli Ikonomi” në Fier, ku ishin të pranishëm edhe kryetari i bashkisë Armando Subashi, deputetët Antoneta Dhima, Adelina Rista dhe Xhevit Bushaj, ishte i pari takim i fushatës që do të vijojë çdo ditë të premte, deri në fund të vitit, me gjimnazistë të të gjithë qarqeve në vend.

Ministria Xhaçka nuk la pa përmendur edhe mundësitë që, Forcat e Armatosura ofrojnë për arsimimin dhe rritjen profesionale jashtë vendit të efektivëve të saj, bazuar në aftësitë e tyre dhe në meritokraci. “FA-të janë një ekip dhe një familje e madhe që kujdesen për njëri-tjetrin. Është familja e aleancës më të madhe në botë, ajo e NATO-s. Ushtarakët tanë kanë mundësinë që të shkollohen në akademitë ushtarake më të mira nëpër botë. Ka kurse kualifikimi dhe mundësi të tjera aftësimi, ka



Shtetet tona kanë nevojë për shkëmbimin e përvojave integruese

Takim i përbashkët i zëvendësministrave të Mbrojtjes të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut

Ditën e hënë, më 11 shkurt 2019, zëvendësministri i Mbrojtjes, z.Petro Koçi ka pritur në takim zyrtar të përbashkët zëvendësministrin e Mbrojtjes të Kosovës, z.Burim Ramadani dhe zëvendësministrin e Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut, z. Bekim Maksuti.

Takimi i zhvilluar në ministrinë e Mbrojtjes kishte karakter diskutimi të përbashkët mbi përvojat në rajon në rrugën e integrimeve në NATO dhe për bashkëpunimin e mëtejshëm midis shteteve në çështjet e politikave të sigurisë dhe mbrojtjes. Zëvendësministri Ramadani vlerësoi lartë takimin konsultues të këtij formati, duke theksuar dëshirën për zgjerimin e përfaqësimit edhe të shteteve tjera në rajon. „Rajoni ynë dhe shtetet tona kanë nevojë të vazhdueshme për shkëmbimin e përvojave në proceset integruese, si dhe thellimin e bashkëpunimit për të promovuar vlerat perëndi-



more të rajonit“, tha zv. ministri Ramadani. Ai, theksoi se Kosova është e përkushtuar në rrugën drejt NATO-s, dhe se anëtarësimi

i shteteve të Ballkanit në NATO, është alternativa më e sigurt për zhvillimin e rajonit të sigurt dhe prosperues.

Baza e NATO-s në Kuçovë

Nivel i shkëlqyer i bashkëpunimit ushtarak SHBA-Shqipëri

Intervista e zëvendësministrit të Mbrojtjes Petro Koçi për gazetën “Sot”

Zoti Koçi, në fund të muajin që kaloi Shqipërinë e vizitoi një gjeneral i NATO, vizita e të cilit u fokusua tek baza që Aleanca do të ngrejë në Kuçovë. Keni një koment dhe a e forcon imazhin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare vëmendja që NATO po i kushton vendit tonë?

Ndërtimi i bazës ajrore të NATO në Kuçovë është një konfirmim i besimit të aleatëve tanë strategjikë te roli i rëndësishëm i Shqipërisë për interesat e Aleancës në rajon dhe votëbesim për politikën e paqes dhe stabilitetit që ndjek vendi ynë në Ballkan. Nga ana tjetër, vendimi shpreh mirënjohjen e partnerëve tanë ndaj kontributit të Forcave tona të Armatosura në misionet ndërkombëtare të NATO. Qeveria Rama qysh në fillimet e qeverisjes e kishte objektiv ndërtimin e një baze ushtarake të NATO në Shqipëri.



Domethënëse në arritjen e këtij objekti ka qenë edhe niveli i shkëlqyer i bashkëpunimit ushtarak SHBA-Shqipëri, ku spikat takimi i ministres Olta Xhaçka me ish-sekretarin e Mbrojtjes Mattis.

Investimi që NATO po bën në Kuçovë është një investim, i cili ndodh për herë të parë në Ballkan pasi Aleanca nuk ka baza në gadishullin tonë. Çfarë përfitimesh do të ketë Shqipëria nga ky investim?

Në radhë të parë baza do të forcojë rolin politik dhe ushtarak të Shqipërisë në Aleancë. Ndërkohë funksionimi i saj do të shëndoshë kushtet për zhvillimin e mëtejshëm të Forcës tonë Ajrore. Do të përshkallëzohet më tej perceptimi ndërkombëtar për sigurinë që ofron vendi ndaj investimeve të huaja dhe patjetër që investimi në vetvete dhe ecuria e bazës në kompleks do të ndikojë psikologjikisht dhe praktikisht në zhvillimin e zonës ku ndodhet baza. Tradita e aviacionit në Kuçovë do të ketë arsye për të rizgjuar krenarinë e këtij profesioni prestigjioz.

Bashkëpunimi me Malin e Zi në nivel biletaral dhe multilateral

Atasheu ushtarak jo resident i Shqipërisë në Malin të Zi, Kolonel Eduart Bala takohet me ministrin e Mbrojtjes të Malit të Zi, z.Predrag Boshkoviç

Ministri i Mbrojtjes Malit të Zi, z.Predrag Boshkoviç ka pritur në një takim zyrtar atasheun ushtarak jo resident të Republikës së Shqipërisë në Malin të Zi, Kolonel Eduart Bala.

Ministri i Mbrojtjes Malit të Zi, z.Predrag Boshkoviç ka pritur në një takim zyrtar atasheun ushtarak jo resident të Republikës së Shqipërisë në Malin të Zi, Kolonel Eduart Bala.

Boshkoviç dhe Bala kanë shkëmbyer mendime mbi bashkëpunimin e deritashëm në mes të Malit të Zi dhe Shqipërisë në fushën e mbrojtjes. Zyrtarët ranë dakord se të dy vendet tona kanë bashkëpunim intensiv dhe efikas në fushën e mbrojtjes në nivel bilateral, i cili është vazhdimisht duke u përmirësuar me anë të shkëmbimit të përvojave dhe trajnimit të personelit, por edhe në nivel multilateral, i cili përmes angazhimit të përbashkët në projekte të formatit rajonal të të dy vendeve në mënyrë aktive kontribuojnë në dialog si një çelës për arritjen e paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor.

Ministri Boshkoviç përgëzoi Kolonel Balën për dhjetë vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe uroi që të dy vendeve tona dhe në të ardhmen, si aleatë në kuadër të Aleancës, të bashkëpunojnë ngushtë dhe të kontribuojnë në ruajtjen e një rajoni të qëndrueshëm.

Kolonel Bala shprehu shpresën se gjatë qëndrimit të tij, do të kontribuojë që bashkëpunimi ushtarak bilateral mes dy vendeve do të zhvillohet vazhdimisht si në projektet bilaterale dhe multilaterale, të cilat nuk kontribuojnë vetëm në efikasitetin e sistemit të mbrojtjes kombëtare, por edhe forcimin e kornizës rajonale të sigurisë.

Kolonel Eduart Bala ka zhvilluar takime të ndara edhe me shefin e Shtabit të Ushtrisë së Malit të Zi, gjeneral brigade Dragutin



Dakiç, Drejtorin e Përgjithshëm për Politikën e Mbrojtjes, z Ivica Ivanoviç, si dhe shefin e Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Andrej Lakić. Gjatë të gjitha ta-

kimeve u theksua përkushtimi për forcimin e bashkëpunimit bilateral me Republikën e Shqipërisë dhe Malit të Zi, në fushat me interes të përbashkët.

Nga Turqia, Britania e Madhe dhe Italia

Xhaçka: Arsimimi i ushtarakëve është prioriteti ynë

Nëntogerët Kamberi dhe Gjergji me rezultate të shkëlqyera në shkollën e Topografisë-Ankara

Arsimimi i ushtarakëve të rinj është prioriteti ynë. Pas përfundimit të akademisë ushtarake në Turqi një vit më parë, nëntogerët Klodian Kamberi dhe Enri Gjergji arritën rezultate të shkëlqyera edhe në kursin bazë në shkollën e Topografisë në Ankara", shkruan ministria Xhaçka në Facebook, më 1 shkurt 2019.

Në fund të vitit që kaloi nëntogerë Klodian Kamberi u diplomua si më i miri në Shkollën e Forcës Tokësore në Ankara, mes 1850 studentëve të tjerë. Klodian Kamberi jo thjesht përfundoi një ndër akademitë më të mira botërore, por u diplomua si studenti më i mirë në Shkollën e Forcës Tokësore në Ankara, mes 1850 studentëve. Ndërsa Kamberi vetë ka shkruar se diplomimi si "Oficeri Më i Mirë i Akademisë", e bën të ndihet krenar pasi ka përfunduar Shqipërinë në mënyrën më të mirë të mundshme. "Çdo gje që kam arritur deri tani, ja dedikoj familjes sime. Fale mbështetjes dhe sakrificave të tyre jam ky që jam sot. Une sot u diplomova nga Akademia e Forcës Tokësore Turke (Turkish Military Academy)", shkruan ai. Gjithashtu Klodian Kamberi ka marrë dhe çmimin "Kadeti i huaj me i mire i vitit" në Turqi. Ndërkohë për vitin 2019-2000 janë dhënë katër bursa studimi në Akademitë Ushtarake në Britaninë e Madhe dhe tre bursa studimi në Akademitë Ushtarake në Itali. Në Britaninë e Madhe: 1 bursë në Akademinë Ushtarake Mbretërore të Forcës Ajrore- Kranwell, për "Kursin fillestar të Oficerit të Forcës Ajrore" në periudhën 02 dhjetor 2019-17 korrik 2020; 2 bursa për të ndjekur kursin "Royal Marines Young Officers Course"-Limpston, në periudhën 1 korrik 2019-14 dhjetor 2020 dhe 1 bursë për të ndjekur "Kursin e titullimit të oficerit të Forcës Tokësore" në Akademinë Ushtarake Mbretërore të Forcës Tokësore në periudhën 10 qershor 2019-07 gusht 2020. Kurse në Itali janë 3 të drejta studimi si: Akademia Ushtarake Modena, 1 kuotë në degën "Karabinieri"; Akademia Ushtarake Detare, Livorno, 1 kuotë në degën "Xhenio detare" dhe në Akademia Ushtarake e Forcës Ajrore, Pozzuoli, 1 kuotë në degën "Pilot".



Xhaçka: Puna dhe përkushtimi shpërblehen

Gjeneral brigade Albert Mullai emërohet komandant i Forcës Tokësore

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka deklaroi se vlerësimi i profesionistëve dhe njerëzve të përkushtuar është motoja e punës në Forcat e Armatosura. Ministrja mori pjesë më 2 shkurt 2019, në ceremoninë e ndërrimit të komandantëve të Forcës Tokësore. Gjeneral brigade Albert Mullai mori detyrën e komandantit të Forcës Tokësore duke zëvendësuar gjeneralmajor Nazmi Cahanin, i cili e mbajti këtë post për më shumë se tre vjet.

“Puna e palodhur, përkushtimi, profesionalizmi gjithmonë do të shpërblehen. Kjo është motoja e punës sonë, është motoja e punës sime është objektivi i punës sime është objektivi që ne i kemi vënë vetes dhe është standardi i panegociueshëm që ne do të zbatojmë në të gjitha strukturat e FA. Por puna dhe zhvillimi më tej i FT nuk ka përfunduar dhe kemi shumë sfida të tjera përpara. Dua t’i shpreh dhe dua ta siguroj gjeneral Mullain se në Ministrinë së Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm do të keni gjithë mbështetjen e duhur për të realizuar qëllimin tonë të përbashkët, përmbushjen e misionit që i është ngarkuar Forcës Tokësore dhe Forcave të Armatosura në përgjithësi.” - tha ministrja Xhaçka në fjalën



Ai do të zëvendësojë gjeneralmajor Nazmi Cahanin, i cili do të jetë përfaqësues ushtarak në selinë e NATO në Bruksel.



e saj. Gjeneralmajor Nazmi Cahani dorëzoi detyrën duke falënderuar gjitha bashkëpunëtorët e tij gjatë tre viteve në krye të Forcës Tokësore, ndërkohë që komandanti i ri i kësaj force gjeneral brigade Albert Mullai falënderoi ministren Xhaçka për besimin dhe e siguroi se fokusi i punës së tij do të jenë stërvitja dhe kujdesi për kushtet e punës, për gjithë efektivet e Forcës Tokësore dhe familjet e tyre. Gjeneralmajor Nazmi Cahani do të vijojë të shërbejë

në Forcat tona të Armatosura, si përfaqësues ushtarak në selinë qendrore të NATO në Bruksel.

Pak më muaj më parë, nën monitorimin e NATO u certifikua Grup-Batalioni i Lehtë i Këmbësorisë, pjesë e Forcës Tokësore, ndërkohë që në qindra stërvitje kombëtare e ndërkombëtare efektivet e kësaj force nuk kanë qenë numra në formacione, por kanë sjellë në vendin e tyre trofe e vlerësimet më të mira nga vendet anëtare të NATO.

Gjeneral brigade Albert Mullai, studimi dhe karriera ushtarake

Arsimimi dhe kualifikimi

Gjeneral brigade Albert Mullai ka lindur më 23 shkurt 1964 në Tiranë. Në vitin 1988 ka mbaruar Akademinë Ushtarake "Skënderbej" dhe nga vitit 1995 deri 1998 ka vazhduar me kurse trajnimi në Mitenwald-Gjermani, Spiez-Zvicër dhe Varna-Bullgari. Në vitin 1999 ka kryer kursin e Politikave të Sigurimit European në "Marshall Center" Garmisch, Paternkirschen, Gjermani; në vitin 2001 Kursin e Politikave të Sigurimit European (GCSP) në Qendrën e Politikave të Sigurimit të Gjenevës, Zvicër; në vitin 2002 Kursin e Terminologjisë së NATO, i zhvilluar në AF-NORTH, NATO, Brunssum; në vitin 2003 Kursin e Familjarizimit me NATO, Bruksel, Belgjikë; në vitet 2003-2005 ka kryer Kursin e Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë; në vitin 2005 Akademinë Diplomatike Shqiptare, Tiranë dhe në vitin 2006 ka kryer Kursin e Politikave të Sigurimit të SHBA, pas 11 Shtatorit, i organizuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA, Universiteti i Kalifornisë, San Diego. Ai zotëron tre gjuhë të huaja: Anglisht, Italisht dhe Rusisht.

Pjesëmarrja në misione të NATO:

Gjeneral brigade Albert Mullai ka marrë pjesë në disa misione të NATO-s. Në vitin 2015-2016 ka qënë Këshilltar i Lartë për Personelin pranë Ministrisë së Mbrojtjes e Shtabit të Përgjithshëm të FA afgane në kuadër të "Resolute Support Mission" të NATO. Në vitin 2013-2016 Atashe i Mbrojtjes i RSH në SHBA, Washington DC, SHBA. Në vitin 2009-2011 Oficer Shtabi për Operacionet dhe Stërvitjen në Përfaqësinë e Përhershme Ushtarake të RSH në NATO, NATO HQ, Bruksel, Belgjikë. Në vitin 2007-2009 Oficer Shtabi për Per-



sonelin (PSE Staff Element) në Shtabin Ushtarak Ndërkombëtar IMS të NATO, NATO HQ, Bruksel, Belgjikë. Në vitin 2006-2007 Përfaqësues në Komitetin Drejtues të Ministerialit të Mbrojtjes të vendeve të Europës Juglindore, SEDM-PMSC. Kurse nga viti 2006 e këtej ka qënë disa here pjesëmarrës në stërvitje shumëkombëshe në Gjermani, Slloveni, Kroaci, FYROM, Bullgari, Rumani, Greqi e Ukrainë.

Karriera ushtarake dhe eksperiencë pune

Me të mbaruar Akademinë Ushtarake "Skënderbej" në vitin 1988 titullohet oficer dhe emërim Komandant Toge Këmbësorie në BrK, Laç; më pas titullohet Komandant Kompanie në Brigadën e Këmbësorisë, Laç dhe po në Laç titullohet Instruktor Stërvitje në S-3 të Brigadës së Këmbësorisë, Laç. Ai kthehet në Tiranë dhe nga vitet 1991-1996 ka punuar Pedagog Zjarri në Akademinë Ushtarake "Skënderbej", Tiranë. Në vitin 1997 Zëvendëseshëf i Seksionit G-3 të Bazës së Furnizimit të

FA, Tiranë dhe në vitet 1997-1999 punon si Zëdhënës i Ministrisë së Mbrojtjes. Në vitet 1999-2000 Specialist në Drejtorinë e Marrëdhënëve me Jashtë të MM, 2000-2002 Specialist në Drejtorinë e Marrëdhënëve me Jashtë të MM, 2002-2003 Shef i Sektorit të Modernizimit dhe Ndërveprimit të J5 në SHPFA, 2003-2005 Kursi i Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë, 2005-2006 Shef i Sektorit të

Marrëdhënëve dypalëshe në Drejtorinë e Politikave dhe Integritimit të MM, 2006-2007 Shef i Sektorit të Arsimit të J-1 në Shtabin e Përgjithshëm të FA, 2007-2009 Oficer Shtabi për Personelin (PSE Staff Element) në Shtabin Ushtarak Ndërkombëtar IMS të NATO, NATO HQ, Bruksel, Belgjikë, 2009-2011 Oficer Shtabi për Operacionet dhe Stërvitjen në Përfaqësinë e Përhershme Ushtarake të RSH në NATO, NATO HQ, Bruksel, Belgjikë, 2011-2012 Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik të Politikave të Personelit, 2012-2013 Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në MM, 2013-2014 Atashe i Mbrojtjes i RSH në SHBA, Washington DC, SHBA, 2014-2015 Shef i Planifikimit Afatgjatë të Komandës Mbështetëse, 2015-2016 Këshilltar i Lartë për Personelin pranë Ministrisë së Mbrojtjes e Shtabit të Përgjithshëm të FA afgane në kuadër të "Resolute Support Mission" të NATO dhe në vitet 2017-2019 punon si Komandant i Akademisë së Nënoficerëve "Thomson", Tiranë.

AIRCOM në mbështetje të Forcës Ajrore Shqiptare

Zhvillohet Simpoziumi i Komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s

Në datat 12-13 shkurt 2019, në drejtimin e komandantit të Komandës Ajrore të NATO, Gjeneral Tod D. Wolters, u zhvillua në Ramstein, Gjermani, Simpoziumi i Komandantëve të Forcave Ajrore të vendeve antare të NATO-s. Në takim morën pjesë Gjenerali Sir James Everard, Zëvendës Komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë, Marshal Stu Evans, Zëvendës Komandanti AIRCOM, Gjeneral Major Claudio Gabellini, Shef i Shtabit, HQ AIRCOM, të gjithë komandantët e Forcave Ajrore të vendeve të NATO, vendeve partnere, si dhe komandantë dhe përfaqësues nga komandat dhe strukturat e NATO/SHAPE, ACT, ACO, NCIA, CAOC, DACCC, LANDCOM, MARCOM etj.

Forcat tona ajrore u përfaqësuan nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore të Forcave tona të Armatosura, kolonel Flamur Hadushi.

Qëllimi i Simpoziumit të Komandantëve të Forcave Ajrore të vendeve antare të NATO-s, ishte shkëmbimi i pikëpamjeve dhe eksperiencave midis NATO Air Com dhe komandantëve të Forcave Ajrore për të përmirësuar bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së hapësirës ajrore të Aleancës dhe asaj partnere.

“Ndërsa hymë në vitin e përvjetorit të 70-të të NATO-s, Aleanca jonë është më e fortë se kurrë”, tha gjenerali Wolters në fjalimin e tij të parë në simpozium. “Ambienti i sotëm kërkon gatishmëri të shtuar dhe një qëndrim përpara për të ruajtur shkallën prej 360 shkallësh. Vitin e kaluar, ne zgjeruan aftësitë e Aleancës duke krijuar një element komandimi dhe kontrolli më të përgjegjshëm për të ofruar energji ajrore dhe hapësirë me spektër të plotë në mbështetje të operacioneve të përbashkëta të NATO-s. Këtë vit do të kemi në fokus përpjekjet e vazhdueshme për të zhvilluar më tej aftësitë tona në shumë fusha, duke përfshirë aftësitë gjithnjë e vigjilente në hapësirën ajrore, hapësirë dhe kibernetike”, shtoi gjenerali Wolters.

Një pikësynim i simpoziumit ishte referimi i Zëvendës Komandantit Suprem të Forcave Aleate në Evropë, Gjenerali Sir James Everard, i cili komunikoi pikëpamjet e tij mbi kontekstin strategjik dhe ofroi njohuri mbi Iniciativën e gatishmërisë së NATO-s, duke përfshirë sfidat e mundshme për Forcat Ajrore të NATO-s.

Komandanti i Komandës Detare të Aleancës, Zëvendës Admirali Sir Clive Johnstone, ndau me ushtarakët e pranishëm në Simpozium vlerësimin e tij mbi sfidat detare në Atlantikun e Veriut dhe qasjen e tij



në forcimin e qëndrimit të gatishmërisë dhe parandalimit. Tema të tjera përfshinin temën kryesore të parandalimit të 360-shkallë, aftësitë e ardhshme të Mbikqyrjes së Aleancës Tokësore, aktivitetet e Komandës Ajrore të NATO-s dhe Afganistani dhe sfidat e zhvillimit për pozicionet e mbrojtjes së integruar ajrore dhe të raketave të NATO-s në të gjithë Zonën e Përgjegjësisë të SACEUR.

Kolonel Hadushi gjatë punimeve të simpoziumit u prit nga komandanti i Komandës së Forcave Ajrore të NATO, gjenerali Tod D. Wolters, i cili përveç të tjerave e falënderoi edhe për pritjen e shkëlqyer që ju bë nga ministri i Mbrojtjes dhe shefi i

Shtabit të Përgjithshëm të FA gjatë vizitës së Tij në Tiranë dhe ritheksoi angazhimin e vazhdueshëm të AIRCOM në mbështetje të zhvillimit të Forcës Ajrore Shqiptare.

Gjithashtu gjatë takimit u zhvilluan takime bilaterale me komandantin e CAOC Torrejon, komandantët e Forcave Ajrore bullgare, italiane, malazeze, sllovene dhe turke, në të cilat u diskutua për Operacionet e Policimit Ajror, mundësinë e rritjes së bashkëpunimit në fushat e trajnimeve të personelit pilot, teknik, radarit si dhe mirëmbajtjes dhe riparimit të teknikës ajrore në kuadër të plotësimin të kërkesave të procedurave për Cross Servicing të mjeteve ajrore.

Ministria Xhaçka:

Vlerësime nga partnerët për efektivet shqiptarë në Letoni

Rreshter Afrim Lama nominohet “Defender of the Week” nga kompania shumëkombëshe e mbështetjes me luftim

Një tjetër vlerësim vjen nga partnerët ndërkombëtarë për Forcat e Armatosura shqiptare. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka informoi ditën e hënë më 18 shkurt, se rreshter Afrim Lama është nominuar “Defender of the Week” nga kompania shumëkombëshe e mbështetjes me luftim. “E lumtur për gjithë grup-batalionin EOD në Letoni, të cilët vazhdojnë traditën fantastike të të na bërit krenarë”, u shpreh Xhaçka. Rreshter Lama, një person i përlur me shkallë të lartë të punës në grup si brenda kontingjentit shqiptar ashtu edhe me të gjithë personelin e grup batalionit. “Gjithë efektivet EOD kanë treguar shkallë të lartë përgjegjshmërie, disiplinë të lartë dhe aftësi të jashtëzakonshme gjatë stërvitjeve të tyre”, vlerësoi ministria Xhaçka.

Xhenierët e FA zbulojnë arsenal municionesh në Pukë

Ngjarjet e vitit 1997 nuk kanë kaluar ende. Pasojat e saj janë akoma të prekëshme. Madje të rrezikshme. Brenda qytetit të Pukës, vetëm 60 metër larg pallateve ku jetojnë dhjetëra familje, rastësisht punonjësit i gjelbërim pastrimit gjatë punës së tyre rutinë, ditore, u befasant jo pak kur gjetën me 22 shkurt një predhë që siç u specifikua më vonë ishte e kalibrit 120 mm. Menjëherë autoritetet locale kanë njoftuar specialistët e strukturave xheniere, pjesë e Forcave të Armatosura. Me të marrë njoftimin Ministria e Mbrojtjes dërgoi urgjent një ekip EOD (explosive ordnance disposal) të Forcave të Armatosura në bashkinë e Pukës. Specialistët



e strukturave xheniere apo ekipi EOD i cili merr pjesë edhe në misionet jashtë vendit si në Republikën e Malit në Afrikë, bëri çminimin e predhës me kalibër 120 mm. Duke bërë kërkime në zonën për rreth, specialistët xhenierë u befasant se nuk bëhej fjalë për një predhë por për një arsenal armësh. Xhenierët e Forcave të Armatosura gjetën edhe 40 granata dore difensive, 6 granata dore ofensive si dhe një granatë dore me bisht.

Nga verifikimet paraprake, dyshohet që këto municione të kenë dalë nga depot e Forcave të Armatosura dhe të jenë hedhur në zonë gjatë trazirave të vitit 1997, duke u shndërruar në një rrezik serioz për jetën e banorëve.

Shpëtohet anija me vela “Sea Shell”

Një anije me vela, me flamur amerikan por me ekipazh izraelit është shpëtuar më 23 shkurt 2019, nga Roja Bregdetare shqiptare në hyrje të kanalit të Korfuzit, pasi kishte raportuar një defekt në motorë.

“Sea Shell” kishte tre veta në bord dhe ishte nisur nga porti i Dubrovnikut, në Kroaci me destinacion Sarandën, por në traverse të Qefalit pësoi difekt në motor, duke mbetur në varësi të erës, ndërkohë personat që ishin në bord u lidhën me radio me Kapitenerinë e Portit të Sarandës, duke kërkuar ndihmë.

Kapiteneria e Sarandës njoftoi menjëherë Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare në Durrës, e cila me miratimin e Komandantin të Forcave Detare, ka angazhuar dy anije të Rojes Bregdetare, përkatësisht “Shkumbini P-03” dhe “Vjosa P-05”, menjëherë pasi dha sinjalin “SOS” të emergjencës. Anija me vela u rimorkiu për në Portin e Sarandës, duke shpëtuar kështu 3 personat që ishin në bordin e saj. Ekipazhi ishte i tëri izraelit, me kapiten Tsafir Lederman, dhe dy të tjerët e identifikuar si Moshe Navot

Niset nga Dubrovniku me flamur amerikan dhe ekipazh izraelit



dhe Liana Navot. Nuk ka munguar pershëndetja e ministres Xhaçka për Rojen Bregdetare e cila si gjithmonë në krye të detyrës! “Ekipazhet profesioniste të motovedetave tona “Vjosa” dhe “Shkumbini” i erdhën në ndihmë tre personave

pas defekteve në motorin e velierës më të cilin ata po lundronin nga Dubrovniku. Falë ndërhyrjes së djemve tanë, tre shtetasit e huaj mbërritën shëndoshë e mirë në portin e Sarandës”, shkruan Xhaçka në facebook.

Policia Ushtarake ka festuar më 1 shkurt 2019, 27-Vjetorin e krijimit të saj. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast në mjediset e kësaj njësie, ishte i pranishëm zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, si dhe drejtues të PU.

Në fjalën e tij zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi e vuri theksin tek përparimi dhe transformimi i bërë në Policinë Ushtarake në këto vite. Po ashtu, Koçi shtoi se roli i PU do të jetë thelbësor edhe në sigurimin e bazës së NATO, që do të ndërtohet në Kuçovë.

“Vendimi i Aleancës për të ngritur Bazën Ajrore në Kuçovë është një votëbesim i ri i partnerëve tanë, jo vetëm për rolin politik edhe ushtarak të Republikës së Shqipërisë në rajonin tonë, por edhe një vlerësim për përparimin e reformave në zhvillimin bashkëkohor të Forcave tona të Armatosura, për këtë kanë meritë të gjitha strukturat tona të FA, përfshirë edhe Policinë Ushtarake, e cila natyrisht do të ketë një rëndësi të veçantë në sigurimin e kësaj baze.”, - tha ai.

I pranishëm në këtë aktivitet, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, tha se Policia Ushtarake ka treguar konsolidim dhe dinamizëm në kryerjen e të gjithë detyrave të ngarkuara në këto 27 vite.

“Për më shumë se çerek shekulli rrugëtim, në vlerësojmë Policinë Ushtarake si një histori sukcesi në përballje me vështirësi, sfida në aktivitete dhe kontribut të prekshëm në mbështetje të gjithë rrugëtimit dhe suksesit të aktivitetit të FA-ve branda dhe jashtë vendit”, - përfundoi Kollçaku Policia Ushtarake u krijua me 1 shkurt të vitit 1992 si një strukturë e domosdoshme për ruajtjen e rendit dhe sigurisë në Forcat e Armatosura.

Policia Ushtarake (PU) ka në misionin e saj ruajtjen e rendit ushtarak në FARSH, garantimin e zbatimit të ligjit nga veprimtaritë e kundërligjshme në FA, mbrojtjen e jetës së personelit, mbrojtjen e pronës shtetërore në administrim dhe përdorim të MM dhe FA, anga-



27 vite Polici Ushtarake

Policia ushtarake garanton sigurimin e bazës së NATO-s në Kuçovë

zhimi në luftën kundër terrorizmit dhe pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse e humanitare. Struktura e PU bën të mundur plotësimin e detyrave dhe objektivave që dalin nga ky mision. Gjatë këtyre viteve të fundit PU, është trajnuar nga specialist të huaj si ata të karabinierisë italiane, policisë ushtarake amerikane, gjermane dhe turke. Gjithashtu ajo po përgatitet edhe si forcë e gatshme për të vepruar në përbërje të strukturës përkatëse të NATO, e aftë dhe e pajisur për shtatshmëri për të përmbushur detyrat.

Policia Ushtarake është një nga strukturat më elitare të Forcave tona të Armatosura që merr pjesë jo vetëm në operacione brenda vendit por edhe në menaxhimin e krizave botërore përkrah aleatëve. Vitet e fundit pajisja dhe modernizimi i Policisë Ushtarake ka përminësuar

dukshëm kapacitetet duke e pajisur këtë njësi me armatim, mjete dhe teknologji bashkëkohore. Ajo ka mision sigurimin dhe ruajtjen e pjesëtarëve dhe pasurive ushtarake, mbajtjen e rregullit dhe disiplinës dhe zbulimin e veprave penale ushtarake. Veprimtaria e Policisë Ushtarake ushtrohet mbi të gjitha subjektet ushtarake e civile, vendase dhe të huaja, me ose pa shtetësi, të cilët, me veprimet e tyre, cenojnë veprimtarinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Policia Ushtarake e ushtron juridiksionin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në përmbushje të ushtrimit të juridiksionit territorial janë organizuar dhe funksionojnë Seksionet e Policisë Ushtarake në rrethe me përhapje, në Kukës, Shkodër, Elbasan, Durrës, Berat, Vlorë, Burrel, Gjirokastër dhe Korçë.



10-vjetori i anëtarësimit të Shqipërisë në NATO

Flota Detare ngre flamurin e NATO-s në Kalanë e Skënderbeut

Shqipëria e mori ftesën për antarësim në Samitin e Bukureshtit më 2 prill 2008. Kurse antarësimi me të drejta të plota u bë në Samitin Strasburg&Kehl në 2 prill 2009.

Më datën 22 shkurt 2019, dhjetëra kuadro dhe detarë të Forcës Detare zhvilluan një aktivitetet tepër të veçantë në Kalanë e Gjergj Kastrioti Skënderbeut, Kepi i Muzhli, Rodon.

Ata në kuadrin e 10-Vjetorit të Anëtarësimit NATO, ngritën simbolikisht Flamurin Kombëtar dhe atë NATO në këtë kala historike, duke i shprehur botës, se luftën dhe idealin e Gjergj Kastriotit, për të qenë pjesë e botës së qytetëruar e bënë realitet stërnipat e tij.

Ky aktivitet i mirë organizuar nga Komanda e Forcës Detare, shënoi një ngjarje të veçantë jo vetëm për detarët, por dhe për komunitetin e Kepit të Rodonit.

Kalaja dhe mjediset e saj morën një pamje e hijeshi të veçantë, ashtu si para 600 vjetësh, kur ushtarët e Skënderbeut dhe prijësit e tyre luftonin kundër pushtesit osman, por dhe shijonin bukuritë që të afrojnë Adriatiku në këtë kep të rëndësishëm të vendit tonë.

Për disa orë kalaja, kullat dhe bedenat e saj përjetuan një "pushtim" të butë nga

bijtë e detit, duke shënuar dhe një akt historik, që starton aktivitetet e shumta që do organizohen në vendin tonë në 10 Vjetorin e Anëtarësimit në NATO. Të tjera aktivitete do pasojnë këtë 10 vjetor, në kepe, gjire dhe kala të tjera të bregdetit shqiptar.

Shqipëria e mori ftesën për antarësim në NATO në Samitin e Bukureshtit më 2 prill 2008. Kurse antarësimi me të drejta të plota u bë në Samitin Strasburg&Kehl në 2 prill 2009. Si data të veçanta në rrugëtimin drejt NATO-s do të përmendim: Për herë të parë në qershor 1992 Shqipëria aplikon dhe pranohet zyrtarisht në Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut, në maj 1993 Shqipëria pranohet Antare e Asamblesë së Atlantikut të Veriut, në gusht 2002 Shqipëria dërgon misionin e parë në Afganistan me 23 veta nga regjimenti "Komando", në maj 2003 Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia së bashku me SHBA nënshkruajnë "Kartën e Adriatik 3-SHBA", kurse gjatë viteve 2004-2008 kanë vazhduar konsultimet e përvitëshme me NATO-n në kuadër të programeve MAP, PARRP, etj.



Paraditen e dates 31 janar u zhvillua në mjediset e Komandës së Batalionit të Forcave Speciale të Forcës Tokësore, ceremonia e ndërrimit të komandantit të këtij reparti elitë të FT. Ceremoninë, e nderoi me pjesëmarrjen e tij komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Nazmi Cahani si dhe shtabi i kësaj njësie.

Në fjalën e tij përshëndetëse komandanti në largim i batalionit të Forcave Speciale kolonel Ilirjan Dauti, shprehu mirënjohjen e tij për çdo ditë të punës së kaluar me efektivat specialë. "...ka qenë nder dhe privilegj, që për një periudhë 19 mujore të jem pjesë e Batalionit të Forcave Speciale. Gjatë kësaj periudhe, kemi punuar të gjithë së bashku për çuarjen më lart të emrit të repartit. Ndihem krenar, që bashkë me ju arritëm të përmbushim me sukses çdo detyrë të ngarkuar nga eprorët tanë. I uroj komandantit të ri sukses dhe ta çojë akoma më përpara emrin dhe prestigjin e BFS"-u shpreh ndër të tjera kolonel Dauti.

Më pas, fjalën e mori komandanti i ri i BFS nënkolonel Ramadan Karakushi, i cili fillimisht falënderoi kolonel Dautin për punën e bërë në drejtim të rritjes profesionale të batalionit, gjatë gjithë periudhës që ai shërbeu si komandant. Më tej, ai shprehu falënderimet e tij të veçanta për ministrin e Mbrojtjes dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA, për besimin e treguar me emërimin e tij, në një detyrë kaq të rëndësishme. "...kolegë të nderuar, së bashku do të vazhdojmë rrugëtimin drejt konsolidimit të mëtejshëm të këtij batalioni. Sfidat e mëdha na presin në përmbushjen e angazhimeve të marra në NATO, si pjesë e komunitetit të Forcave Speciale. Konsolidimi i mëtejshëm i kapaciteteve operacionale, rekrutimi dhe përzgjedhja e personelit, vetëzhvillimi dhe mbështetja e burimeve njerëzore, do jetë synimi i përbashkët për të ardhmen."- tha ndër të tjera nënkolonel Karakushi.

Gjeneralmajor Cahani, e nisi fjalën e tij përshëndetëse me falënderimet dhe mirënjohjen e tij personale për punën përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar nga kolonel Dauti ish-komandant i batalionit të Forcave Speciale, për aq kohë sa ai drejtoi këtë batalion. "...ka qenë kënaqësi e madhe për mua, të punoja me ushtarake si kolonel Dauti, i cili ka punuar me disipinë të lartë për rritjen profesionale të trupës së Forcave Speciale. Jam i bindur, që edhe në

Forca Tokësore

Nënkolonel Karakushi, Komandanti i ri i Forcave Speciale



detyrën e re që ai ka marrë, do jetë i aftë të tregojë vlerat e tij më të mira, si ushtarak karriere." - tha gjeneralmajor Cahani.

Ai shprehu gjithashtu besimin e tij të plotë, se edhe komandanti i ri i Batalionit të Forcave Speciale nënkolonel Ramadan Karakushi, do të jetë i aftë që punën e mirë të bërë nga kolonel Dauti do ta çojë në një stad edhe më të lartë, duke bërë që efektivët e këtij reparti të vazhdojnë ta meritojnë emrin e lavdishëm të efektivave elitë të Forcave të Armatosura. Ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët.

Komandanti i ri i Batalionit të Forcave Speciale të Forcës Tokësore nënkolonel Ramadan Karakushi, është lindur në vitin 1976, në Kukës. Karriera e tij ushtarake si oficer fillon në vitin me diplomimin në Akademinë Ushtarake "Skënderbej" në vitin 1998 në specialitetin "Tanke". Detyra e tij e parë, do të ishte ajo e komandantit të togës. Në vitin 1999 nënkolonel Karakushi përfundon me sukses kursin e Forcave Speciale nën drejtimin e instruktorëve turq, duke u barë

kështu pjesë e batalionit të Forcave Speciale. Në këtë batalion ai do të zhvillonte më tepër karrierën e tij ushtarake në detyra të ndryshme si komandant grupi special, shef shtabi dhe për të arritur tek detyra më e lartë ajo e komandantit të Batalionit të Forcave Speciale të Forcës Tokësore. Nënkolonel Karakushi regjistron në CV e tij një numër të konsiderueshëm kursesh trajnimi kryesisht në fushën e Forcave Speciale ku mund të përmendim: kursi i Forcave Speciale; kursi i luftimit të afërt; kursi për ruajtjen e personaliteteve; kursi i instruktorit; kursi për programin ekzekutiv OCC; kursi bazë për operacionet e mbështetjes së paqes; kursi për operacionet speciale kundër terrorizmit; etj. Nënkolonel Karakushi ka qenë pjesë e një sërë misionesh paqeruajtëse në zonat më të nxehta të globit si: Afganistan në vitet 2004, 2011; 2013, Irak 2005 dhe 2008. Ai është dekoruar disa herë me medalje të ndryshme për shërbimet e tij ndaj atdheut. Komandanti i batalionit të Forcave Speciale të Forcës Tokësore nënkolonel Ramadan Karakushi është i martuar dhe ka një fëmijë.

Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit në Vaun e Dejës

Kursantët shfaqën interes për stërvitjen taktike që kryhet nga personeli i b1kFT

Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit (KTHOSH) zhvilloi më datë 18 shkurt 2019, një vizitë në Batalionin I të Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b1kFT) në Vaun e Dejës Shkodër. Kjo vizitë vjen në kuadër të programit akademik që zhvillohet në Akademinë e Forcave të Armatosura. Gjatë vizitës në komandën e b1kFT ushtarakët e KTHOSH u njohën nëpërmjet një briefing të mbajtur nga shefi i Shtabit të këtij batalioni, major Gëzim Tushi me historikun, misionin, pjesëmarrjen në misione si dhe angazhimin në operacione brenda vendit, ku ky batalion është shquar gjithmonë për reagim në kohë dhe me profesional-



izëm në çdo lloj situatë ku është kërkuar ndërhyrja e tyre.

Nga ana e kursantëve u shfaq interes i veçantë sidomos në drejtim të stërvitjes taktike që kryhet nga personeli i b1kFT. Në

vijim të vizitës së tyre në b1kFT, Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit (KTHOSH) ka vizituan mjediset e punës dhe të stërvitjes së efektive të këtij reparti elitë të Forcës Tokësore.

Akademia e Forcave të Armatosura (AFA)

Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) si institucion i arsimit të lartë ushtarak, krahas shumë fushave studimore dhe veprimtarive që kanë të bëjnë me sigurinë e mbrojtjes, ka si objektiv në programin e saj edhe bashkëpunimin me institucione shtetërore qendrore dhe lokale në kuadrin e njohjes së veprimtarisë së tyre dhe të shkëmbimit të eksperiencës.

Në këtë kuadër, Kursi i Lartë i Oficerit (KLO) i Akademisë së Forcave të Armatosura, organizoi një vizitë mësimore një ditore në Prefekturën dhe Bashkinë e Qarkut Fier.

Kursi i Lartë të Oficerit, kryesohej nga Dekani i Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Kolonel Prof. Asoc. Dr Agim Sula, Shefi i Grupit të Operacioneve të përbashkëta/pedagog përgjegjës për KLO, Kolonele Irela Nebiaj, si dhe pedagogët e Departamentit të Lidershipit dhe Shkencave Shoqërore.

Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse, në zbatim të detyrimeve të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të Ligjit Nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të Ligjit Nr. 8756, "Për Emergjencat Civile", etj. Në Bashkinë e Qytetit Fier, grupi u prit nga Kryetari i kësaj

Organizimi dhe funksionimi i njësisë së vetëqeverisjes vendore

Vizitë mësimore e Kursit të Lartë të Oficerit në Prefekturën dhe Bashkinë e Qarkut Fier

bashkie, z. Armando Subashi dhe nga Drejtori i Emergjencave Civile pranë kësaj bashkie, z. Arben Dimo. Në prezantimin nga ana e tyre, si dhe në bashkëbisedimin e zhvilluar, kursantët u njohën me organizimin dhe funksionimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore në Bashkinë Fier, funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e bashkisë, si dhe vizionin, arritjet, projektet kryesore të realizuara, e në zbatim e sipër. Në të njëjtën kohë u vlerësua, bashkëpunimi i shkëlqyer që ka Bashkia Fier me FARSH, në raset e emergjencave dhe fatkeqësive natyrore.

Pas vizitës në Bashkinë e qytetit, grupi vizitoi gjithashtu edhe Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier. Në këtë takim, ata u pritën nga Prefekti i këtij Qarku, z. Baki Bala. Në prezantimin e organizuar nga ana e Prefektit, grupi u njoh me organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni, misionin dhe kompetencat në përmbushje të detyrave të Prefektit si përfaqësues

i Këshillit të Ministrave në nivel qarku si edhe për rolin e Institucionit të Prefektit, në drejtim të marrëdhënieve me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Degët Territoriale, Policisë Vendore, menaxhimin e Emergjencave Civile dhe marrëdhëniet me qytetarin. Takimet e realizuara e përmbushën më së miri qëllimin e vizitës mësimore të Kursit të Lartë të Oficerit, të cilat u reflektuan dhe në diskutimet e përbashkëta dhe pyetjet e bëra nga grupi.

Vizitat u mbyllën me foto të përbashkëta si në Bashki ashtu edhe në Prefekturën e Qarkut Fier.

Kolonele Irela Nebiaj





Iniciativa e Ndërtimit të Integritetit, si një disiplinë e NATO-s

Ekipi i NATO-s vizitë pune dy ditore në KDS

Në interes të Inicativës së Ndërtimit të Integritetit (Building Integrity- BI), një ekip i Divizionit për Çështjet dhe Politikat e Sigurisë së NATO-s (PASP), i përbërë nga Shefi i NATO BI, zonja Lidra Zegali dhe zonja Susanne Pond, zhvilluan një vizitë pune dy ditore në mjediset e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, respektivisht në datat 7 dhe 8 shkurt 2019.

Qëllimi i kësaj vizite është hulumtimi i mundësive për integrimin, përfshirjen e qeverisjes së mirë, llogaridhënies dhe integritetit në sistemin e arsimit dhe aftësisimit ushtarak, bazuar në programin e referencës së Ndërtimit të Integritetit. Pasi janë pritur në një takim nga Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof.Asoc. Bajram Begaj, ekipi i NATO-s realizoi një mbledhje pune në institucionin e AFA. Në këtë takim, morën pjesë Zv/Komandanti i AFA, Zv.Komandanti/Zv.Rektori i AFA, Kolonel Prof.Asoc. Dr. Edmond Braneshi, Shefi i Seksionit të Grupit të Studimeve Strategjike, Kolonel Vullnet Doka, shefi i Degës së Arsimimit, Stërvitjes dhe Kurrikulave në KDS, Kolonele Razie Mehmeti, shefat e Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, të departamenteve të Përgatitjes së Oficerit



Iniciativa e Ndërtimit të Integritetit, si një disiplinë e NATO-s, zbatohet nëpërmjet ndërthurjes me programet arsimore të vendeve anëtare dhe partnere

të Ri, të Strategjisë dhe Historisë, të Operacioneve të AFA, etj.

Ekipi nëpërmjet një prezantimi të mbajtur nga zonja Lidra Zegali, i njohu pjesëmarrësit në takim me iniciativën e Ndërtimit të Integritetit, si një disiplinë e NATO-s, zbatimi i së cilës bëhet nëpërmjet ndërthurjes së saj në programet arsimore të vendeve anëtare dhe partnere, si pjesë e Planit të Vepërimit të Aleancës për Ndërtimin e Integritetit, të miratuar nga ministri i Mbrojtjes në vitin 2016.

Zv.Komandanti/Zv.Rektori i AFA, Kolonel Prof.Asoc. Dr. Edmond Braneshi, i paraqiti ekipit të

NATO-s, një prezantim mbi misionin, rolin dhe përgjegjësitë e institucionit të Akademisë së FA, informoi në lidhje me koceptin e arsimimit ushtarak në FA, si dhe kurrikulat akademike për vitin akademik 2018-2019. Diskutimet e përbashkëta ishin mjaft frytdhënëse duke konsistuar në ndërthurjen e programeve mësimore të AFA në Inicativën e BI të NATO-s.



Iniciativa BI e NATO-s pjesë e programit arsimor të AFA-s

Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof.Asoc. Bajram Begaj, priti ekipin e Divizionit për Çështjet dhe Politikat e Sigurisë së NATO-s (PASP)

Komandanti i KDS, Gjenerl Brigade Prof.Asoc. Bajram Begaj, priti ditën e enjte të javës që kaloi, më 7 shkurt 2019, në një takim të veçantë ekipin e Divizionit për Çështjet dhe Politikat e Sigurisë së NATO-s (PASP), i përbërë nga Shefi i NATO BI, zonja Lidra Zegali dhe zonja Susanne Pond, të ardhur në vendin tonë në kuadër të Iniciativës së Ndërtimit të Integritetit (Building Integrity-BI) të NATO-s.

Në takim morën pjesë: Zv.Komandanti/Zv.Rektori i AFA, Kolonel Prof.Asoc.Dr. Edmond Braneshi, Shefi i Seksionit të Grupit të Studimeve Strategjike, Kolonel Vullnet Doka, shefi i Degës së Arsimimit, Stërvitjes dhe Kurrikulave në KDS, Kolonele Razie Mehmeti,

Pasi iu uroi mirëseradhjen, komandanti i KDS, gjeneral Begaj, ndër të tjerash u shpreh se ndjehet i vlerësuar për këtë bashkëpunim në interes të realizimit të iniciativës së BI së NATO-s. Duke qënë se kjo iniciativë është pjesë e programit arsimor të AFA, që zhvillohet në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, gjeneral Begaj, e njohu ekipin me KLSM dhe ecurinë e tij ndër vite, si kursi më i lartë institucional për fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Synimi i institucionit tonë-theksoi gjeneral Begaj, është të jetë një



kurs model për rajonin, dhe për këtë kërkohet mbështetja nëpërmjet iniciativës së BI të NATO-s". Në emër të ekipit, zonja Susanne Pond, vlerësoi me tone positive strukturimin e mirë të institucionit arsimor ushtarak shqiptar, duke shprehur angazhimin e saj maksimal për një partnership të ngushtë. Zonja Susanne Pond, u shpreh se së shpejti është menduar organizimi i një workshopi, ku do të identifikohet

hen të gjitha zgjidhjet e mundshme në funksion të Ndërtimit të Integritetit, si dhe promovimit të Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes në rajon e më gjërë. Aktiviteti i Divizionit për Çështjet dhe Politikat e Sigurisë së NATO-s (PASP), është i pari i këtij lloji që po zhvillohet dhe që parashikohet të ndiqet nga të tjera në vijimësi, pas hartimit të një plani të përbashkët të veprimit edhe në nivele më të larta.

EKIPI I EKSPERTËVE TË OKB-SË

Testohen kapacitetet e deklaruara të FARSH

Një ekip i OKB ka zhvilluar një vizitë vlerësuese në Forcat e Armatosura të RSH, për kapacitetet e FARSH të cilat janë të deklaruara në sistemin e OKB për ti angazhuar dhe përdorur nëse do të kërkohet në misionet nën drejtimin e OKB.

Me anë të një prezantimi në Shtabin e Përgjithshëm, ekipi vlerësues i përbërë nga personel nga OKB dhe Komanda Evropiane e Forcave Amerikane, u njohën me kapacitetet dhe mundësitë e FARSH për të kontribuar në misionet e mundshme të drejtuara nga OKB. Gjatë vizitës vlerësuese ekipi i OKB me anë të disa mësimeve treguese të zhvilluara nga efektiv të Batal-



ionit Komando dhe Policisë Ushtarake si dhe EOD, iu bë e mundur të njihesh nga afër me këto kapacitete të tjera të cilat FARSH është e gatshme ti angazhojë nëse do të kërkohet nga OKB, sikundër FARSH është në fazat e fundit përgatitore për të dërguar dy oficerë personel femër në mision paqeruajtës në Sudanin e Jugut, nën drejtimin e Organizatës së Kombeve të

Bashkuara. Në përfundim të vizitës vlerësuese, e cila është në vazhdim të komunikimeve dhe përpjekjeve të Forcave të Armatosura Shqiptare, për tu angazhuar në misionet e drejtuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, u dakortësua për hapat e mëtejshme që do të ndiqen për ti konkretizuar këto përpjekje.



Zhvillohet “Ora e komandantit” në KDS

Në mjediset e auditoriumit të MM u zhvillua në ditët e para të muajit shkurt ora e komandantit të KDS. I ftuar për të lektuar këtë radhë ishte Gjeneral Brigade® Bardhyl Hoxha, me detyrë shëf i departamentit të Sigurisë dhe Mbrojtjes në QDK, i cili lektoi temën e draftit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes.

Në këtë aktivitet morën pjesë stafi pedagogjik i AFA, kursantë të KKSHP, KLO, personel i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Qëllimi i prezantimit të gjeneral Hoxhës, ishte angazhimi dhe metodologjia e përdorur për hartimin e draftit të Rishikimit Strategjik i Mbrojtjes (RSM), duke e pëshkruar si një proces ciklik kombëtar dhe ndër-institucional në nivelin strategjik, e shoqëruar me një analizë racionale të interesave dhe objektivave kombëtarë, zhvillimeve të reja në mjedisin e sigurisë, përfitimëve dhe detyrimeve nga sistemi i mbrojtjes kolektive dhe zhvillimit ekonomik e financiar të vendit.

Për rreth një orë, u diskutua rreth rëndësisë së RSM-së, e cila përshkruan interesat strategjike kombëtarë dhe politikat e mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë; trajton rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sigurisë; evidenton sasinë dhe cilësinë e kapaciteteve që duhet të

Gjeneral® Bardhyl Hoxha: Metodologjia e RSM bazohet në modelin e aleatëve

disponojnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), sipas skenarëve më të mundshëm të përdorimit të tyre, nëpërmjet argumentimit analitik të rolit të tyre në mjedisin e ri të sigurisë, për të bërë të mundur funksionimin si një forcë e mirëpajisur dhe e mirëtrajnuar dhe e aftë profesionalisht, për të realizuar misionin kushtetues.

Për pjesëmarrësit u bë prezent se metodologjia e përdorur në zhvillimin e RSM është bazuar tek modeli i vendeve aleate për planifikimin e mbrojtjes, i orientuar drejt përcaktimit dhe krijimit të kapaciteteve të kërkuara, duke pasur si referenca kryesore Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, e cila jep vlerësimin e rreziqeve të brëndshme dhe të jashtme dhe fuqizimin e sektorit të mbrojtjes, Strategjinë Ushtarake, Programin e Qeverisë për rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes, Planin Afatgjatë të Zhvillimit të FARSH dhe Konceptin Strategjik të NATO-s, si

dhe vijon me analizën e rrethanave që ndikojnë në sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare, gjithashtu ajo përcakton kapacitetet e nevojshme për realizimin e misionit kushtetues dhe detyrave kryesore të FARSH.

Diskutimet ishin tepër interaktive dhe kishin të bënin me atë që RSM është në mbështetje dhe ndërveprim të plotë me dokumentet strategjike dhe bazën aktuale ligjore e normative në fushën e mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, me harmonizimin dhe integrimin e kapaciteteve operacionale të FARSH me elementë të tjerë të fuqisë kombëtare, duke rritur ndërveprueshmërinë me forcat e Aleancës. Diskutimet e këtij lloji në orën e Komandantit të KDS janë tepër efektive e frytdhënëse për gjithë kontingjentin kursant të AFA, stafin pedagogjik dhe personelin e KDS, duke e kthyer në një traditë pozitive diskutimet lidhur me zhvillimet aktuale në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Modernizimi i aftësive luftarake një detyrë e përhershme

Gjeneral brigade Albert Mullai vizitë njohëse në Batalionin I të Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b1kFT)

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Albert Mullai zhvilloi ditën e mërkurë, më 6 shkurt, një vizitë njohëse në Batalionin I të Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b1kFT) me venddisklokim në Vaun e Dejës, Shkodër, ku nëpërmjet një prezantimi të përgatitur me këtë rast u njoh me misionin, detyrat dhe problematikat kryesore, me të cilat hasen efektivat e b1kFT gjatë punës së tyre të përditshme.

Gjeneral brigade Mullai, gjatë kësaj vizite njohëse u shpreh mes të tjerash se: "Angazhimi juaj në misionet paqeruajtëse në Afganistan si dhe kontributi i b1kFT në operacionet e Emergjencave Civile, në luftën kundër përmbytjeve dhe zjarreve, ka bërë që ju të meritoni jo vetëm mirënjohjen e lidërshiptit ushtarak dhe atij civil të Ministrisë së Mbrojtjes, por edhe të popullsisë së zonës. Si komandant i Forcës Tokësore, ju siguroj se do keni gjithmonë mbështetjen time, të Shtabit të Forcës Tokësore, por pa dyshim edhe të Shtabit të Përgjithshëm, çdo ditë të punës tuaj në drejtim të realizimit të misionit të përbashkët. Kujdesi për krijimin e kushteve optimale të punës si dhe mbështetja për familjet tuaja, do të jetë gjithmonë në fokus të punës time. Duke qenë se ne jemi anëtarë të NATO, kjo na bën jo vetëm përfitues të sigurisë, por kërkon nga ne të jemi edhe kontribues të denjë. Modernizimi dhe rritja e aftësive luftarake të reparteve të Forcës Tokë-



sore, duke përfshirë rritjen e nivelit të stërvitjes, në kushte sa më reale, ngritja e poligoneve taktike dhe atyre të qitjes, aftësitë fizike dhe gjuhët e huaja, duhet të mbeten për të gjithë ne një detyrë e përhershme".

Më pas, i shoqëruar nga komandanti i b1kFT, nënkolonel Ali Mali, gjeneral brigade Mullai vizitoi mjediset

e punës dhe të stërvitjes si dhe të jetesës së personelit të Batalionit I të Këmbësorisë së Forcës Tokësore. Vizita e komandantit të Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai në Batalionin I të Këmbësorisë vjen në kuadër të njohjes dhe prezantimit me personelin e reparteve vartës të Forcës Tokësore.

GARNIZONI I FORCËS TOKËSORE

Përfundon Kursi i 40-të i Avancuar i Nënoficerit në ANO

Paraditen e sates 8 shkurt 2019 në mjediset e Garnizonit të Forcës Tokësore, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të 40-të të Avancuar të Nënoficerit.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm Komandanti i FT, Gjeneral Brigade Albert Mullai, Shefi i DASK në KDS Kolonel Razi Mehmeti, Zv/Komandanti i ANO N/Kolonel Bedri Qoli, dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën përshëndetëse të tij, Zv/komandanti i ANO-së, N/kolonel Bedri Qoli theksoi se: "Është kënaqësi e veçantë pasi nuk është e lehtë të përfundosh një proces mësimor 8-javor me rezultate shumë të mira duke pasur parasysh vështirësitë dhe problemet që mund të hasen gjatë rrugës si rrjedhojë e dinamikës së punës në ANO, por dhe e vetë Forcave të Armatosura". Kolonel Qoli, vlerësoi punën e bërë nga të gjithë kursantët dhe instruktorët për të arritur nivele më të larta, duke përmendur faktin që përfundimi me sukses i këtij kursi, tregon se ANO po rritet dhe zhvillohet dukshëm si institucioni i vetëm i hartimit, zbatimit e drejtimit të programeve për gjithë kontigjentin e nënoficerëve në FA. Në përfundim të fjalës së tij, Zv/komandanti

i ANO, kolonel Bedri Qoli, ju uroi suksese kursantëve në detyrat e mëtejshme, duke siguruar se përpjekjet, sakrificat, ndershmëria dhe përkushtimi i kursantëve, jo vetëm që nuk do të shpërfillen, por ato do të kenë vlerësimin dhe seriozitetin maksimal të lidërshiptit ushtarak.

Në emër të të gjithë kursantëve, Tetar Mehdi Kordhaku falenderoi të gjithë trupën mësimdhënëse të ANO-së, që me shumë profesionalizëm, këmbëngulje dhe durim i mësoi, stërviti kursantët, duke bërë që të ndihen më të sigurt në detyrat që do të ju besohen në të ardhmen.

Ceremonia më pas vijoi me shpërndarjen e certifikatave për të gjithë kursantët, duke konkluduar me realizimin e një fotoje të përbashkët. Kursi i Avancuar i Nënoficerit, është një kurs që zhvillohet për një periudhë 12-javore, i fokusuar në lëndët Lidërshipt, Rregullore-Ligjshmëri, Taktikë, SHLT, Përgatitje Zjarri, Përgatitje Fizike, Testime. Objektivi i këtij kursi është avancimi i nënoficerit në karrierën e tij si zëvendës komandant toge, ofrimi i njohurive teoriko-praktike për drejtimin e togës dhe niveleve të njësuara me të si dhe shkëputjen nga përgjegjësia në grup në aftësi e përgjegjësi si drejtues dhe lider.

Në periudhën 5-7 Shkurt 2019 në ambientet e garnizonit të Zall-Herrit u zhvillua konferenca e parë planizuese në lidhje me stërvitjen ndërkombëtare "Albanian Effort 19". Në këtë stërvitje që pritet të zhvillohet në muajin Shtator në poligonin kombëtar të Bizës, pritet të marrin pjesë trupa nga 11 vende pjesëmarrëse si: Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Maqedonia, Sllovenia, Mali i Zi, Kosova, Italia, Kroacia, Polonia Bosnje&Herzegovina .

Në ditën e parë të konferencës përfaqësuesit e shteteve pjesëmarrëse në stërvitjen "Albanian Effort" morë një informacion të përgjithshëm në lidhje me qëllimin dhe objektivat e mundshëm të stërvitjes. Më pas në ditët në vijim puna u organizua në sindikata të vecanta.

"Albanian Effort" është stërvitje e kategorisë së Emergjencave Civile dhe e formës së ushtrimeve fushore. Qëllimi i propozuar për "Albanian Effort 19" është rritja e njohurive dhe e profesionalizmit të njëjësive dhe drejtuesëve ushtarakë të të Forcave të Armatosura Shqiptare si dhe e partnerëve ndërkombëtarë në lidhje me panizimin dhe ekzekutimin e spektrit të plotë të NA5CRO si pjesë e Taskë Forcës së Kombinuar të NATO-s me theksin në nivelin taktik.

Ndër objektivat kryesorë të stërvitjes fushore "Albanian Effort" mund të përmendim:

Planizim dhe ekzekutim të Operacionit në Përgjigje të Krizave; testimi i procedurave të Komandimit Kontrollit (C2); operacion në një ambient ndërkombëtar sipas procedurave të NATO-s; përdorimi i Procedurave Staandarte të Komunikimit të NATO-s; përdorimi i gjuhës operacionale

Forca Tokësore Zall Herr



Konferenca e parë planizuese për stërvitjen "Albanian Effort-19"

Në këtë stërvitje që zhvillohet në shtator në poligonin kombëtar të Bizës, pritet të marrin pjesë 11 vende si: Shqipëria, SHBA, Britania e Madhe, Maqedonia, Sllovenia, Mali i Zi, Kosova, Italia, Kroacia, Polonia dhe Bosnje&Herzegovina.

të NATO-s; përdorimi i hartave dhe simboleve të aprovuar nga NATO; operacion sipas rregullave të angazhimit të NATO-s; përdorimi i procedurave të NATO-s në lidhje me logjistikën; përdorimi i standarteve të NATO-s në lidhje me mbështetjen mjekësore; trajnimin dhe evakuimin; zhvillimi i planit të bashkëpunimit;

Sipas shefit të operacioneve të Forcës Tokësore kolonel David Rroku, stërvitja "Albanian Effort" është stërvitja më e rëndësishme e Forcës Tokësore për vitin 2019 ku pritet të angazhohen një numër të konsiderueshëm forcash, ku fokusi do të jetë batalioni "Komando" i kësaj njësie.

Kolonel Rroku beson se kjo stërvitje do të ndikojë pozitivisht, në rritjen e aftësive profesionale të trupave të angazhuara në të duke filluar që nga pjesa e drejtuesëve e deri tek ushtari i fundit që do të jetë pjesë e "Albanian Effort". Pjesëmarrja e aleatëve në NATO- apo e shteteve partnere, i jep një tjetër dimension këtij ushtrimi stërvitor fushor, duke krijuar mundësinë e rritjes së aftësive ndërvepruese dhe bashkëvepruese në një ambient multinacional.

Nga ana tjetër shefi i operacioneve të Forcës Tokësore, beson se angazhimi i njësisë në këtë lloj stërvitje është një përgjegjësi e shtuar dhe një sfidë, për të cilën ai është i bindur se nën drejtimin e komandantit të Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai,

efektivët e FT do të dinë ta përballojnë me sukses. Konferenca e parë planizuese e "Albanian Effort" do të pasohet në muajt në vijim nga konferenca të tjera ku do të bëhen detajimet e mëtejshme për mbarëvajtjen e kësaj stërvitje.

Rikonicion në Krujë, në kuadër të Stërvitjes “Joint Reaction-19”

Do të marrin pjesë Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Bosnje-Hercegovina, Kosova, dhe USAEUCOM

Në interes të zhvillimit të Konferencës Kryesore Planëzuese(MPC) në mjediset e Bashkisë Krujë, u zhvillua takimi i Grupit Kryesor të Planëzimit(CPT). Në këtë takim, morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i EC, zoti Haki Çako, përfaqësues nga kjo drejtori, përfaqësues nga prefekturat Durrës dhe Tiranë, përfaqësues nga Bashkia Durrës dhe Krujë, përfaqësues nga komisarati i Policisë Krujë, specialist për EC nga Drejtoria e J9 në SHP, z. Arben Molla, si dhe specialisti i planëzimit nga Qendra e Simulimit e KDS, z. Vladimir Bullari.

Qëllimi i këtij takimi ishte njohja e pjesëmarrësve në stërvitje me skenarin e stërvitjes, etapat e planzimit dhe zhvillimit të stërvitjes si dhe përcaktimin e rajonit ku do të zhvillohet etapa live e stërvitjes. Në fund të këtij takimi nga drejtori i EC, u vunë detyra konkrete për t’u realizuar nga pjesëmarrësit në këtë takim.

Stërvitja “Joint Reaction-19”, është një stërvitje që do të zhvillohet në kuadër të A5, me pjesëmarrjen



e shteteve si: Shqipëria në rolin e vendit pritës, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Bosnje-Hercegovina, Kosova, USAEUCOM. Stërvitja “Joint Reaction-19” është konceptuar të zhvillohet me simulim dhe live, ku pjesa e simulimit do të mbulohet drejtpërdrejt nga Qendra e Simulimit e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Pas vizitës njohëse të zhvilluar ditën e djeshme në Batalionin I të Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b1kFT), komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Albert Mullai ndaloi ditën e enjte të javës që kaloi në vizitën e tij të radhës në Batalionin III të Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b3kFT) në Poshnje, Berat. Në takimin e zhvilluar me komandantin dhe Shtabin e këtij reparti, gjeneral brigade Mullai u njoh më konkretisht me punën dhe angazhimet e tyre të përditshme, në interes të realizimit të misionit si një nga repartet kryesore të FT.

Komandanti i Forcës Tokësore duke vlerësuar efektivat e b3kFT për angazhimet dhe arritjet e tyre të deritanishme, theksoi mbështetjen e pakursyer që ata do të kenë gjithmonë nga ana e tij dhe Shtabit të FT. “Ju garantoj ju dhe efektivat që ju drejtoni, se tek unë do të gjeni gjithmonë mbështetjen maksimale, për realizimin e çdo detyre sado e vështirë të jetë. Unë besoj se puna e përbashkët në grup, mbështetja që ne duhet t’i japim njëri - tjetrit, do të na i bëjë sfidat me të lehta dhe më të përballueshme. Profesionalizmin, sakrificën dhe përkushtimin tuaj, unë e kam parë edhe para se të merrja detyrën e komandantit të



POSHNJE, BERAT

Puna në grup i bën sfidat me të lehta dhe më të përballueshme

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Albert Mullai vizitë njohëse në Batalionin III të Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b3kFT) në Poshnje, Berat

Forcës Tokësore. Vazhdoni të mbani lart moralin dhe shpirtin e krenarisë, duke ditur që gjithmonë do të keni jo vetëm mirënjohjen dhe mbështetjen time, por mbi të gjitha të popullit shqiptarë dhe të familjarëve tuaj, të cilët jam i bindur se ndihen çdo ditë

krenarë për ju dhe punën e mrekullueshme që ju bëni”, - u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Mullai. Vizita e komandantit të Forcës Tokësore vijoi me inspektimin e mjediseve të punës dhe stërvitjes së efektiveve të Batalionit III të Këmbësorisë.



NATO dokumentar për Kuçovën

Gjenerali Tod Wolters: “Shqipëria vend me rëndësi kritike”

Baza e Kuçovës jo vetëm do të rikthejë lavdinë e dikurshme të atij aeroporti, por do jetë edhe baza e parë e NATO-s në Ballkanin Perëndimor.

Kanali televiziv i NATO-s i ka kushtuar një kronikë kësaj baze ajrore, një projekt ky sa ambicioz, aq edhe i rëndësishëm jo vetëm për sigurinë tonë kombëtare, por mbi të gjitha për sigurinë rajonale. Kryeministri Edi Rama, ditën e martë, uroi mirëmengjes me këtë kronikë të transmetuar nga kanali televiziv i NATO-s.

“Mirëmengjes dhe me këtë kronikë të mirëseardhur nga kanali televiziv i NATO-s kushtuar Bazës së Kuçovës, ju uroj një ditë të mbarë”, shprehet kryeministri Rama.

Në kronikën e kanalit televiziv të NATO-s thuhet se: “Në Shqipëri gjendet një varrezë aeroplanësh MIG. MIG 15, 17 dhe 19 nuk përdoren më. Aeroplanët i përkasin kohës së regjimit komunist dhe

vendndodhja e tyre është baza ajrore e Kuçovës. Në Kuçovë ka pasur gjithnjë e më pak aktivitet me kalimin e viteve. NATO ka rënë dakord të investojë 51 milionë euro për të modernizuar Kuçovën”.

Modernizimi do ta sjellë Kuçovën në standartet e NATO-s

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, shprehet se “modernizimi i bazës ajrore të Kuçovës është

shumë i rëndësishëm dhe tregon se Aleanca është ende shumë aktive në të gjithë rajonin tonë”.

“Kjo tregon gjithashtu se Shqipëria është një anëtar i besueshëm i NATO-s. E gatshme të marrë përsipër më shumë përgjegjësi në të mirë të paqes dhe sigurisë në të gjithë rajonin”, nënvizon Meta.

Sipas tij, modernizimi do ta sjellë Kuçovën në standartet e NATO-s. “Modernizimi përshin riparimin e pistës, të asfaltit dhe



të depos, si dhe i shton rajonit një bazë ajrore të NATO-s", shton Meta. Ndërsa Gjenerali Tod Walters, Komandant në Komandën Ajrore të Forcave Aleate shprehet se "afërsia me rajonin lidhet me të gjithë kontinentin europian. Kur i hedh një sy rajonit të Adriatikut kur shikon krahun jugor të kontinentit europian paqja dhe prosperiteti është i rëndësishëm". "Për këtë arsye, Shqipëria në rajon, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor bëhet një vend me rëndësi kritike. Shqipëria hyri në NATO në 2009-ën. Ajo ka kontribuar për shumëfishimin e misioneve të NATO-s përfshi Bosnje-Hercegovinën, Kosovën dhe kanë dhënë një mbështetje të vendosur", theksoi Walters.

Ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë, Olta Xhaçka, shprehet se "sot, rreth 10% e forcave tona të armatosura është dislokuar në operacione dhe ne do të na pëlqente të mendonim se ne nuk jemi thjesht konsumatorë të sigurisë, por jemi edhe eksportues të sigurisë". Sipas saj, përtëritja e Kuçovës përfaqëson vazhdimin e bashkëpunimit Shqipëri-NATO.

Ndihemi fat që jemi këtu dhe të jemi pjesë e NATO-s

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama thekson se "të qenit pjesë e NATO-si jep një vendi një burim të ri energjie për të ecur përpara dhe kjo është absolutisht ajo që na bën të ndihemi me kaq fat të jemi këtu dhe të jemi pjesë e kësaj organizate".

Investimi në bazën ajrore të Kuçovës mundëson transformimin e kësaj hapësire në një aeroport ushtarak me standardet e NATO-s. Ky investim do të krijojë mundësi të reja për zhvillim ekonomik e social të gjithë kësaj zone, ku ndërtimi i një baze ajrore të teknologjisë së fundit, jo vetëm do të thotë më shumë punësim, por edhe më shumë ekonomi e konsum në një rreze të caktuar rreth saj.

Qendra Stërvitore e Garnizonit Pezë-Helmës

Fillojnë kurset EOD niveli I dhe Kursi i Avancuar i Oficerëve (KAO)

Kursi përfundon më 10 maj dhe marrin pjesë 31 kursantë nga të gjitha strukturat e FA

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Garnizonit Pezë-Helmës të Komandës Mbështetëse u zhvillua më 18 shkurt ceremonia e fillimit të kurseve më të rëndësishme që zhvillohen në këtë qendër, kursi EOD niveli I, si dhe Kursi i Avancuar i Oficerëve (KAO) në specialitetin Furnizim dhe Transport - Mirëmbajtje. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Përparim Gega, komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Shkëlzen Mhillaj, si dhe përfaqësues nga Shtabi



i KM. Në fjalën e hapjes komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Shkëlzen Mhillaj, pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë ceremoni, shprehu kënaqësinë e tij të veçantë për një fillim të mbarë të kurseve. Kursi KAO dhe EOD-I janë kurse institucionale të cilat synojnë formimin profesional të oficerëve të Forcave të Armatosura me qëllim dhënien e njohurive tekniko

- profesionale, organizative, metodike dhe aftësimin në rol të drejtuesit të ardhshëm të nën repartefve në FA si dhe formimin profesional të ushtarakëve në shërbimin EOD duke i përgatitur pjesëmarrësit në rolin e operatorit EOD Niveli I dhe nd/operatorit EOD niveli II në operacionet EOD, për zgjidhjen e detyrave të ndryshme EOD brenda dhe jashtë vendit në operacione luftarake dhe jo luftarake".

Zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Përparim Gega në fjalën e tij përshëndetëse, në emër të komandantit të KM përcolli urimet më të mira për një fillim sa më të mbarë të këtyre kurseve, ku më pas u ndal tek misioni që ka kjo Qendër Stërvitore në trajnimin dhe edukimin e oficerëve dhe nënoficerëve sipas fushave të përgjegjësisë që ka Komanda Mbështetëse. Në këto kurse marrin pjesë rreth 31 kursantë nga të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura. Kurset përfundojnë më datë 10 maj 2019.

Shkolla e Trupës Bunavi, Vlorë

Përfundon stërvitja fushore tre ditore me kursin SIA

Sipas një plani metodik të hartuar në bazë reparti, për tre ditë me radhë në Shkollën e Trupës Bunavi, Vlorë, me kursantët e kursit SIA, u realizua një ushtrim stërvitor fushor. Stërvitja fushore u zhvillua në afërsi të rajonit të dislokimit, sipas një skenari i cili mbështetet në detyrat që vlerësohen në stërvitje.

Qëllimi i zhvillimit të kësaj stërvitje fushore, ishte t'u siguronte efektivave mundësinë të tregonin dhe shfaqnin aftësitë e tyre individuale e për të vënë në zbatim njohuritë e marra gjatë gjithë Stërvitjes Individuale të Avancuar, në një situatë konkrete në terren; kryerja e marshimit dhe përqendrimi në rajonin e bazimit, zbatimi i rregullave të marshimit, si dhe vendosja në vendndalesë me ngritje fushimi.

Në përfundim të ushtrimit stërvitor fushor, Komandanti i Shkollës së Trupës Kolonel Ardian Lulaj, ka përgëzuar të gjithë ushtarët dhe personelin pjesëmarrës në këtë stërvitje, për motivimin, disiplinën dhe profesionalizmin e treguar gjatë kësaj stërvitjeje.



KOMANDA MBËSHTETËSE

Trajnim për procedurat e reja të teknologjisë së informacionit

Në mjediset e Komandës Mbështetëse nisi trajnimi me specialistët e Ndërlidhjes (IT) që punojnë në strukturat e kësaj komande. Qëllimi i këtij trajnimi është aftësimi dhe dhënia e njohurive të mjaftueshme, bazuar në kërkesat e certifikimit të administratorëve të rrjeteve kompjuterike, për instalimin dhe aplikimin e procedurave të reja në këto rrjete kompjuterike, të personelit që aktualisht punon në strukturat e Ndërlidhjes dhe Teknologjisë së Informacionit në Komandën Mbështetëse. Në këtë trajnim marrin pjesë rreth 20 specialistë IT-je, të cilët do të trajnohen për mjediset e transmetimit nëpërmjet Teknologjisë së Informacionit si dhe instalimeve e konfigurimeve në rrjetet kompjuterike.

Sipas shefit të Ndërlidhjes në Komandën Mbështetëse, nënkolonel Arben Hoxha, prioritet kryesor i këtij trajnimi do të jetë zhvillimi i praktikës në instalimin e rrjeteve kompjuterike për t'iu përgjigjur automatizimit të buri-
meve të mbrojtjes mbi sistemin e menaxhimit të TOP, Logjistikës, Sistemeve të Trajnimit dhe Gadishmërisë, Infrastrukturës si dhe programit financiar "Alfa Web". Ky trajnim zhvillohet nga një personel i kualifikuar i kryesuar nga Ing. toger Greta Tako. Trajnimi do të zhvillohet në harkun kohor të dhjetë ditëve, ku në përfundim personeli i trajnuar do të pajiset me certifikatën përkatëse.

Stërvitja Individuale e Avancuar

Ditë certifikimi në Shkollën e Trupës Bunavi, Vlorë

Është mbyllur me sukses në fillim të kësaj jave kursi i Stërvitjes Individuale të Avancuar (SIA), në Shkollën e Trupës Bunavi, në specialitetet "Këmbësori", "Logjistikë", "Ndërlidhje" dhe "Detari". Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, morën pjesë: Shefi i Shtabit i KDS Kolonel Riza Zaja, përfaqësues nga Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, Shefi i Qendrës Stërvitore të Detarisë dhe personeli i Shkollës së Trupës.

Komandanti i Shkollës së Trupës Kolonel Ardian Lulaj, në fjalën e tij, pasi falënderoi oficerët e nënoficerët për angazhimin e përkushtimin e tyre përgjatë periudhës së kursit, u shpreh ndër të tjerash se: "Jeta

në kushte kazerme dhe aktiviteti stërvitor në Shkollën e Trupës, ju ka kompletuar si ushtarë të vërtetë, të aftë për të marrë përsipër detyra më të rëndësishme në misione brenda dhe jashtë vendit".

Në emër të Komandantit të KDS, përshëndeti dhe Shefi i Shtabit të KDS Kolonel Riza Zaja, duke ju uruar kursantëve të sapo certifikuar suksese në detyrat e tyre të mëtejshme.

Në vijim, për ushtarët, detarët dhe instruktorët të cilët gjatë kursit janë dalluar për arritje të larta në disiplinë dhe stërvitje, u ndanë certifikata vlerësimi. Ceremonia u mbyll me realizimin e një fotoje të përbashkët me të sapo certifikuarit.



Roli i Shqipërisë në NATO

Ambasada e SHBA-së takim me nxënësit në Durrës

Ambasada e SHBA-së në Tiranë ka zhvilluar më 17 shkurt 2019 një takim me nxënësit e shkollave të mesme në Durrës për të diskutuar rreth rolit të Shqipërisë në NATO.

"Për të shënuar përvjetorin e 10-të të Anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, Atasheu i Mbrojtjes i SHBA Jimmy Hilton; Atasheu i Mbrojtjes i Polonisë Tomasz Koperwas; dhe Koordinatorin në Kabinetin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm Fisnik Shtini, u takuan me nxënësit e pesë shkollave të mesme në Durrës, për të diskutuar mbi rolin e Shqipërisë në NATO dhe rëndësinë e Aleancës", shprehet ambasada e SHBA-së.

Po ashtu, ambasada shprehet se "Pas një kuici interaktiv rreth NATO-s, nxënësit i bënë pyetje panelit rreth punës së tyre në ushtri dhe sfidat me të cilat përballen teksa i shërbejnë vendeve të tyre dhe Aleancës".



Në batalion e Forcave Speciale të Forcës Tokësore, u organizua të mërkurën, më 20 shkurt, ceremonia përkujtimore me rastin e 7-vjetorit të rënies në krye të detyrës së kapiten Feti Voglit, në Afganistan. Pjesëmarrës në ceremoni ishin: shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, drejtorë drejtorish nga SHPPFA, si dhe familjarët e Dëshmorit të Atdheut Feti Vogli.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneral brigade Kollçaku, në fjalimin drejtuar pjesëmarrësve në ceremoni ndër të tjera tha: "... kapiten Vogli u nda nga jeta para kohe 7 vjet më parë, për lirinë në emër të atdheut, duke dhënë kontributin e tij më të çmuar duke bërë sakrificën më sublime, jetën e tij për Aleancën dhe për sigurinë dhe paqen që ne kërkojmë dhe që Aleanca kërkon. Shqipëria, këtë vit feston 10 Vjetorin e Anëtarësimit në NATO dhe ky 10 - Vjetor nuk do të ishte i tillë dhe nuk do të krenoheshin dot aq sa krenohemi, pa kontributin, pa gjakun dhe sakrificën e kapiten Voglit, pa kontributin dhe sakrificën e të gjithë ushtarakëve shqiptarë, brenda dhe jashtë vendit, të cilët janë me të vërtetë elita e shoqërisë, janë ata që i përgjigjen të parët urdhrorit, kushtimit dhe na bëjnë të ndihemi krenarë. Në emër të ministres së Mbrojtjes dhe Shtabit të

Kapiten Vogli u nda nga jeta para kohe 7 vjet më parë, për lirinë në emër të atdheut, duke dhënë kontributin e tij më të çmuar duke bërë sakrificën më sublime, jetën e tij për Aleancën dhe për sigurinë dhe paqen që ne kërkojmë dhe që Aleanca kërkon. Shqipëria, këtë vit feston 10 Vjetorin e Anëtarësimit në NATO dhe ky 10 - Vjetor nuk do të ishte i tillë dhe nuk do të krenoheshin dot aq sa krenohemi, pa kontributin, pa gjakun dhe sakrificën e kapiten Voglit



Përgjithshëm, dua t'ju siguroj ju dhe nëpërmjet jush familjarët e kapiten Voglit, se ne nuk harrojmë. Ai do të jetë gjithmonë në zemrat tona, do të jetë gjithmonë burim frymëzimi dhe përkushtimi..."

Përshëndeti ceremoninë, komandanti i batalionit të Forcave Speciale nënkolonel Ramadan Karakushi, i cili

bëri një përshkrim të shkurtër të jetës dhe veprës së kapiten Voglit do të shprehej: "...dëshmorët gjithnjë bien në frontet e luftës, në emër të lirisë dhe për hatër të lirisë, por të lirisë për të tjerët. Ky është tregues se liria paguhet gjithmonë shtrenjtë, prandaj dëshmorët gjithmonë lenë amanete. Edhe



7-vjetori i rënies në krye të detyrës në Afganistan

Përkujtohet Dëshmori i Atdheut kapiten Feti Vogli

Fetiu ynë ka lenë amanet, amanet na ka lenë atdheun e kombin për t'i mbrojtur e për t'i bërë të paprekshëm. Amanet na ka lenë të ruajmë dhe të rrisim krenarinë për përkatësinë kombëtare, për të treguar kudo ku jemi dhe vemi se jemi shqiptarë se jemi bij të shqipeve dhe se jemi qëndrestarë".

Në përfundim të ceremonisë, të pranishmit vendosën kurora me lule pranë bustit të kapiten Feti Voglit.

Për të përkujtuar 7-Vjetorin e rënies së kapiten Feti Voglit në krye të detyrës, kontingjenti i Forcave Speciale shqiptare së bashku me përfaqësuesi e lartë ushtarak në

Kabul, Afganistan, zhvilluan edhe ata një ceremoni përkujtimore.

Dëshmori i Atdheut kapiten Feti Vogli, pjesëtar i Forcave Speciale shqiptare, humbi jetën tragjikiht gjatë një sulmi të pabesë në Afganistan. Vepra e tij, vazhdon të ngelet burim frymëzimi për të gjithë ushtarakët shqiptarë.



6 SHKURT 1981 -
NJË DITË E PAHARRUAR

38-Vjetori i rënies së Dëshmorëve të Fekenit

Në kuadër të 38 Vjetorit të Dëshmorëve të rënë në stërvitjen e Fekenit, paraditen e ditës së mërkurë, më 6 shkurt 2019, pranë Obeliskut të ngritur në garnizonin "Skënderbej", u zhvillua një ceremoni përkujtimore. Në këtë event, ishin të pranishëm Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku, Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof.Asoc. Bajram Begaj, stafi pedagogjik i AFA, kursantë të KKSHP, KLO, si dhe familjarë e të afërm të dëshmorëve.

Në emër të Shtabit të Përgjith-



shëm dhe Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, në Obeliskun e Dëshmorëve të Fekenit, u vunë kurora me lule nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku dhe Komandanti i

KDS, Gjeneral Brigade Prof.Asoc. Bajram Begaj, u bënë nderime e homazhe nga të afërmit e familjarët e të rënëve, si dhe u mbajt një minutë heshtje, për nder të tyre.

Në fjalën e rastit, Zv/komandanti



e shenjtë”.

Shefi i Shtabit të FA, Gjeneral Brigadë Bardhyl Kollçaku, nga ana e tij, iu drejtua familjarëve të dëshmorëve se bijtë e tyre dhe studentët e atëhershëm të FA, janë dhe do të ngelen yje të frymëzimit për cdo kënd në FA. “Profesioni i ushtarakut, për nga natyra ka vështirësitë dhe sfidat e veta, të cilat kërkojnë përkushtim e angazhime ngandonjëherë dhe sakrifikuese - u shpreh gjeneral Kollçaku. Prandaj, ne përulemi me respekt të thellë ndaj vetmohimit, e jetës së tyre. Ata do të kujtohen brez pas brezi e me respekt për atë vetmohim, si simbol i sakrificës dhe gadishmërisë. Kujtimi i tyre do të mbetet gjithmonë i paharuar- përfundoi gjeneral Kollçaku.

Edhe sot, janë të gjalla dhe të paharruara figurat e dashura të: Dushan Shametaj, Nikollaq Bero, Çlirim Pulaj, Bilbil Pashaj, Aleko Gjoni, Qemal Lika, Besnik Shehu, Pëllumb Rrapo, Ilir Gramatiko, Nexhip Çopa, Bujar Aga. Ata ranë në fushat e stërtyjes. Ata vinin nga krahina të ndryshme dhe secili kishte nga një histori personale të veçantë. Por ata kishin një qëllim të përbashkët; jetën e kishin vënë në shërbim të gatishmërisë për të mbrojtur Atdheun.

i AFA, Kolonel Edmond Braneshi, ndër të tjerash vuri në dukje se: “Sot po kujtojmë me respekt këtë ditë të 38 vjetorit të rënies së 11 shokëve tanë në krye të detyrës, të pedagogëve tanë të mrekullueshëm, Dushan Shametaj, Çlirim Pulaj e Nikollaq Beros, të bashkëmoshatarëve dhe të shokëve tanë të grupit, Bilbil Pashaj, Aleko Gjoni, Qemal Lika, Besnik Shehu, Pëllumb Rrapo, Ilir Gramatiko, Nexhip Çopa, Bujar Ago, të cilët nuk mundën të dilnin të gjallë nga goditja e atij or-

teku të tmerrshëm. Ne –violet Kolonel Braneshi, vazhdojmë ti kujtojmë me respekt dhe mirënjohje, sepse ata sakrifikuën jetën e tyre për të shpëtuar shokët, bënë atë që ne nuk mundëm të bënim për ta, dhe si të tillë gjithmonë do të mbeten në ballin e nderit të Forcave të Armatosura. Dëshmorët e Fekënit, do të mbesin në piedestalin e blertë të Forcave të Armatosura si dëshmitarët e rrugës nga ato vijnë, të vendosmërisë që i karakterizon të dashurisë së përherëshme për popullin, shokët dhe tokën



Merastin e Ditës Ndërkom-bëtare të Sporteve (CISM-2019), në kodrat e Liqenit Artificial, në Tiranë, Forcat e Armatosura shqiptare zhvilluan paraditen e ditës së hënë, më 18 shkurt 2019, aktivitetin “Dita e vrapimit të CISM - 2019”.

“Dita e vrapimit të CISM - 2019”, filloi me një ceremoni hapjeje tek amfiteatri duke vijuar më pas me një kros masiv në të cilin morën pjesë 250 ushtarakë të komandave të forcave, njësisve dhe repartëve autonome të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Gara u zhvillua në dy disiplina, 10 km për vrapuesit djem dhe 5 km për vrapueset vajza.

Në vendin e parë për djem u rendit major Bledar Mesi i Policisë Ushtarake, i ndjekur nga ushtar profesionist Jurgen Liçaj nga Batalioni II i Forcës Tokësore. Në vendin e tretë u rendit ushtar profesionist Kostandin Cipi nga Batalioni Komando i Forcës Tokësore.

Në kategorinë e vajzave, vendin e parë e zuri ushtare profesioniste Romina Daja nga Batalioni Komando i Forcës Tokësore. Në vendin e dytë u rendit ushtare profesioniste Artemisa Axhami nga Policia Ushtarake, ndërsa në vendin e tretë u rendit ushtare profesioniste Kristiona Mitaj, nga Batalioni II i Forcës Tokësore.

Trofetë simbolikë dhe certifikatat për tre vendet e para në të dyja disiplinat u dorëzuan nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku.

Gjeneral brigade Kollçaku, pasi falënderoi organizatorët për masat e marra për zhvillimin e këtij aktiviteti dhe në veçanti Bashkinë e Tiranës për mundësimin e ambienteve të amfiteatrit në Liqenin Artificial, si dhe uroi fituesit dhe përgëzoi pjesëmarrësit në garë, u shpreh ndër të tjera: “Me qëllim promovimin e vlerave më të mira të sportit në radhët e ushtarakëve, shpreh bindjen se dhe në vazhdimësi ne do të organizojmë edhe aktivitete të tjera sportive në rang FA, ashtu sikundër këtë vit kemi synime për rezultate të larta në lojërat olimpike verore në Wuhan, Kinë me atletë si Luiza Gega, Franko Burraj, Bledar Mesi, me taek wondo, me boks dhe mundje...”, u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Kollçaku.

“Ditës së vrapimit të CISM-



MORËN PJESE 250 USHTARAKË TË FA

“Dita e vrapimit të CISM-2019”

Në vendin e parë për djem u rendit major Bledar Mesi i Policisë Ushtarake, kurse për vajza, vendin e parë e zuri ushtare profesioniste Romina Daja nga Batalioni Komando.

2019”, iu bashkua edhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj, i cili shprehu kënaqësinë që ndodhej në këtë aktivitet sportiv kaq domethënës dhe jo vetëm, u shpreh se Bashkia e Tiranës dhe Forcat e Armatosura shqiptare kanë pasur dhe vijojnë të kenë një bashkëpunim të shkëlqyer.

“Gjej rastin të falënderoj Forcat e Armatosura për gjithë bashkëpunimet e deritanishme jo vetëm

në aktivitetet sportive por edhe në emergjencat civile dhe veçanërisht strukturat xhënierë të cilat kanë kontribuar dhe vijojnë të kontribuojnë në ndërtimin e urave “bailey”, në ndihmë të komunitetit. Forcat e Armatosura janë shembull për t’u ndjekur nga të gjithë për gatishmërinë, disiplinën, korrektesinë dhe ndershmërinë e tyre...” u shpreh ndër të tjera Z. Veliaj në këtë aktivitet.



CISM (International Military Sport Council), është Këshilli Ndërkombëtar i Sporteve Ushtarake, me 138 vende pjesëmarrëse, midis tyre edhe Shqipëria. CISM-Këshilli Ndërkombëtar i Sporteve Ushtarake e themeluar në vitin 1948, është një nga organizatat më të mëdha multidisiplinare në botë. CISM është organizata e dytë më e madhe disiplinore sportive pas Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

Por historia e tyre fillon më parë, kur në vitin 1919 lojërat e para u zhvilluan në Paris me 1500 atletë që konkuruan në 24 sporte dhe përfaqësonin 18 vende për të vazhduar në vitin 1946 me lojrat të cilat u zhvilluan në Berlin, Gjermani. Pikërisht këtë vit, pra në maj të vitit 1946 krijohet Këshilli Sportiv i Forcave Aleate nga Kolonel Debrus dhe Major Mollet, Këshilli i cili u shua në vitin 1947. Kjo i hapi rrugën krijimit të institucioni më të gjërë, tashmë botëror: Këshilli Ndërkombëtar i Sporteve Ushtarake (CISM) në 18 shkurt të vitit 1948.

Eshtë një nga organizatat botërore sportive në të cilat përfaqësohet numri më i madh i disiplinave. Dita e vrapimit të CISM zhvillohet çdo vit nga vendet anëtarë të kësaj organizate duke u kthyer në ditën ku ushtarakë dhe civilë vrapojnë së bashku në gjithë botën nën flamurin e sportit dhe paqes. Ky aktivitet ka si qëllim promovimin e aktiviteteve sportive dhe edukimit fizik ndërmjet Forcave të Armatosura për të ushqyer paqen nëpër botë. Motoja e CISM-it është "Miqësi nëpërmjet Sportit", (Friendship through sport) dhe bazohet në tre shtylla të sportit, edukimit dhe solidaritetit. Kjo është në përputhje me filozofinë dhe idealet që u caktuan në deklaratën e misionit të CISM në vitin 1998, të nënshkruar nga të gjitha vendet anëtare. Sekretariati i Përgjithshëm gjendet në Bruksel, Belgjikë.

CISM organizon çdo vit mbi njëzet Kampionate Botërore Ushtarake për rreth 30 konkurse të ndryshme sportive, kontinentale dhe rajonale, Lojërat Botërore të Ushtrisë dhe më së fundi Lojrat e Dimrit dhe Lojrat Botërore të Kadetëve. CISM gjithashtu investon shumë në mënyrë të konsiderueshme në sport për aktivitetet e paqes dhe solidariteti është një nga nismat kryesore.

Por historia e tyre fillon më parë, kur në vitin 1919 lojërat e para u zhvilluan në Paris me 1500 atletë që konkuruan në 24 sporte dhe përfaqësonin 18 vende për të

Sportistët tanë ushtarakë drejt Kinës

Kush është Këshilli Ndërkombëtar i Sporteve Ushtarake?



vazhduar në vitin 1946 me lojrat të cilat u zhvilluan në Berlin, Gjermani. Pikërisht këtë vit, pra në maj të vitit 1946 krijohet Këshilli Sportiv i Forcave Aleate nga Kolonel Debrus dhe Major Mollet, Këshilli u shua në vitin 1947. Kjo hapi rrugën krijimit të institucioni më të gjërë, tashmë botëror: Këshilli Ndërkombëtar i Sporteve Ushtarake (CISM) në 18 shkurt të vitit 1948.

Anëtarët e parë ishin Belgjika, Danimarka, Franca, Luksemburgu dhe Holanda. Në 1950, Argjentina dhe Egjipti u bënë anëtarë, në vitin 1951 Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vitin 1952 Iraku, Libani, Pakistani dhe Siria, në vitin 1954 Brazili. Gjatë Luftës së Ftohtë, vendet anëtare të Paktit të Varshavës ishin të organizuara në Komitetin Sportiv të Aleatëve të Armatuar (SKDA) dhe vetëm pas rënies të Murit të Berlinit, pra gjatë viteve 1990 ato u antarësuan në Këshillin Ndërkombëtar të Sporteve Ushtarake. Konkretisht në vitet 1991-1995, pas rënies së Murit

të Berlinit, 31 vende të reja u bënë anëtare dhe u bashkuan me CISM.

Lojërat Botërore të Ushtrisë janë një ngjarje multisportesh që organizohen çdo katër vjet që nga viti 1995. Lojrat e fundit botërore ushtarakë u zhvilluan në tetor 2015, Mungyeong-Koreja e Jugut ku morën pjesë 105 vende. Rusia kryesoi tabelën e medaljes me 59 ari, 43 argjend dhe 33 bronz. Brazili ishte i dyti me 34 ari, 26 argjend dhe 24 bronz. Kina kapi 32 ari, 31 argjend dhe 35 bronz për të përfunduar tre të parat. Në 18 deri 27 tetor 2019, Lojrat Botërore Ushtrarakë do të zhvillohen në Wuhan të Kinës ky synohet të marrin pjesë edhe Forcat tona ushtarakë. "Këtë vit, tha Gjenerali brigade Bardhyl Kollçaku, në aktivitetin e zhvilluar më 18 shkurt 2019, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Sporteve (CISM-2019), kemi synime për rezultate të larta në lojërat olimpikë verore në Wuhan, Kinë me atletë si Luiza Gega, Franko Burraj, Bledar Mesi, me taekwondo, me boks dhe mundje...".



Ditën e dielë, më 17 shkurt 2019, në përvjetorin e 11-të të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në sheshin „Skënderbeu“ të Prishtinës, parakaluan kuadratet e Ushtrisë së Kosovës para mijërave qytetarëve dhe udhëheqësve shtetëror. Ceremonia solemne e manifestimit filloi me intonimin e Himnit të Kosovës nga Orkestra Frymore e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në manifestimin qendror merrnin pjesë udhëheqësit shtetërorë të Kosovës; presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj, kryeministri i Republikës Shqipërisë Edi Rama, ambasadori i SHBA-ve, Philip Kosnett, vëllai i Komandanti legjendar Rifat Jashari, ministra dhe mysafirë të shumtë, ambasadorë, diplomatë, përfaqësues të KFOR-it, si dhe mijëra qytetarë të Kosovës dhe trojeve etnike.

Në kuadër të ceremonisë shtetërore ishin të pranishëm edhe ministri i Mbrojtjes Rustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënant Rrahman Rama, zyrtarë të lartë të ministrisë, gjeneralë dhe oficerë të FSK-së. Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, gjatë fjalimit të tij, në përvjetorin e 11-të të Pavarësisë, pos tjerash tha se FSK-ja është krenaria e Kosovës.

„Para nesh kemi një ushtri profesionale, e cila është në shërbim dhe mbrojtje të shtetit më të ri në Evropë, e gatshme për të kontribuar për paqe në rajon dhe botë. Vendimi për themelimin e ushtrisë ishte i drejtë, legjitim dhe mesazh historik“ tha pos tjerash Presidenti Thaçi. Pas fjalës së presidentit, komandanti i parakalimit gjeneral brigade Enver Cikaqi, raportoi para presidentit Hashim Thaçi, për gatishmërinë e kuadrateve të Forcës së Sigurisë së Kosovës për parakalim. Kuadratet e FSK-së, parakaluan duke filluar nga Togu Ceremonial, Batalioni i Parë i BRSH-së, Batalioni i Dytë i BRSH-së dhe



17 SHKURT 2008-17 SHKURT 2019

FSK-ja është krenaria e Kosovës

FSK-ja parakalon në përvjetorin e 11-të të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës

Batalioni i Tretë i BRSH-së, Brigada e Mbështetjes Operacionale, Regjimenti i Mbrojtjes Civile, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, Qendra për Studime Universitare dhe Orkestra Frymore e FSK-së. Kuadratet e FSK-së, gjatë parakalimit u shoqëruan me brohoritje dhe duartrokime nga qytetarët e pranishëm në sheshin Skënderbeu. Ndërkohë në mëngjesin e ditës së dielë, Qeveria e Kosovës ka nisur aktivitetet në shënim të përvjetorit të njëmbëdhjetë të Pavarësisë së Kosovës me mbledhjen e saj solemne të drejtuar nga kryeministri Ramush Haradinaj. „Pavarësia jeton në ne dhe me ne dhe për Pavarësinë të gjithë kemi rrëfimin tonë“, tha ai duke shprehur konsideratën dhe vlerësimin më të lartë për përvjetorin e shënimit të ngjarjes më të madhe të Kosovës dhe popullit të saj. „Në këtë ditë do të shprehim gjithë falënderimin tonë për të rënë për liri, për miqtë dhe të gjithë ata që ndihmuan rrugëtimin e Kosovës drejt realizimit të aspiratave për liri dhe pavarësi. Me kujdesin më të madh jemi përballur me të gjitha temat që i kanë dalë para Kosovës, para Qeverisë, dhe njëkohësisht me respektin më të madh për interesin e qytetarëve të vendit. Ka shumë vendime, shumë ligje, reforma, vendime të mëdha sikurse ishte ushtria, vendimet që lidhen me Trepçën,

me resurset tjera ekonomike“, tha kryeministri Haradinaj në fjalën e tij para kabinetit qeveritar.

Duke folur për fillimin e dekadës së dytë të Pavarësisë së Kosovës, kryeministri Haradinaj shtoi se janë edhe më të vendosur që të ecin rrugës së konsolidimit të shtetit dhe stabilitetit të tij dhe se synojnë që në këtë vit vendimtar ta përmbyllin edhe dialogun me Serbinë, me njohjen reciproke të vendeve tona, dhe të vazhdojnë në procesin e rrugëtimin drejt anëtarësimit në NATO dhe Bashkim Evropian.

„Gjatë rrugëtimin tonë kemi hasur në sfida, jemi në sfida, do të sfidohejmë në të ardhmen, por bindja ime është që Kosova nuk e ka luksin të bëjë hapa prapa, por vetëm hapa para dhe këtë do t'ua kërkojmë dhe do t'ua shpëgojmë miqve tanë se hapat prapa e dobësojnë Kosovën, e dobësojnë besimin e qytetarëve në shtetin e tyre“, tha kryeministri Haradinaj.

Në fund të fjalës së tij, kryeministri Ramush Haradinaj ka uruar të gjithë qytetarët e vendit për përvjetorin e njëmbëdhjetë të shpalljes së Pavarësisë. Gjithashtu, urimin e tij kryeministri e ka drejtuar edhe për të gjithë miqtë dhe aleatët e Kosovës, të prirë nga SHBA-ja, me shprehje të falënderimit dhe përkushtimit për të vazhduar rrugëtimin drejt progresit, lirisë, dhe mirëqenies së qytetarëve.

JONATHAN PARISH DHE MICHEL SOULA NË PRISHTINË

Kosova shpreh vullnetin për anëtarësim në NATO

Ministri Berisha dhe Komandant Rama pritën delegacionin e lartë të NATO-s

Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenat Rrahman Rama pritën më 20 shkurt në Ministrinë e Mbrojtjes një delegacion nga Aleanca Veri-Atlantike (NATO), në krye me Jonathan Parish, zëvendës asistent i Sekretarit Gjeneral të NATO-s për Operacione si dhe drejtorin e Operacioneve dhe Misioneve të NATO-s, z. Michel Soula.

Ministri Berisha dhe gjeneral Rama zhvilluan takime të ndara me delegacionin e NATO-s, në të cilat u bisedua kryesisht për situatën e sigurisë në Kosovë e



rajon, zhvillimet rreth tranzicionit të FSK-së, marrëdhëniet Kosovë-NATO dhe perspektivën e këtyre marrëdhënieve në të ardhmen. Krerët e FSK-së e njoftuan drejtorin e Operacioneve të NATO-s mbi zhvillimin

e FSK-së, planet për të ardhmen, rikonfirmuan vullnetin e Kosovës për avancimin e marrëdhënieve me KFOR-in, NATO-n, si dhe konfirmuan vendosmërinë e Kosovës për anëtarësim në NATO.

Seminari ndërkombëtar “Backbone”

Amerikanët çertifikojnë 26 nënoficerë të FSK-së

Në kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë, u mbajt ceremonia e certifikimit të nënoficerëve të cilët përfunduan seminarin ndërkombëtar „Backbone”. Në këtë seminar ndërkombëtarë i cili u zhvillua në kuadër të zhvillimit të nënoficerëve për përgatitjen e tyre, për të punuar në ambiente ndërkombëtare, morën pjesë mbi 60 pjesëtarë, ku 26 nga ta pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) kurse të tjerët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), Sllovenisë, Turqisë dhe Polonisë. Për t’i nderuar pjesëmarrësit dhe instruktorët amerikanë të cilët mundësuan realizimin e këtij seminary, të pranishëm në këtë ceremoni ishin përfaqësues të FSK-së, Ambasadës Amerikane, KFOR-it dhe US Balkan National Support Element.

Para të pranishmeve foli Rreshteri i Parë i Komandantit të FSK-së, Genc Metaj, i cili në bashkëpunim me përfaqësuesin e EUCOM-it, Cris Addigton, organizuan këtë seminar. Rreshteri Metaj pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit në emër të komandantit të FSK-së, gjeneralletenat Rrahman Rama, u shpreh se: „Është kënaqësi e imja dhe e FSK-së që patëm mundësi që të shkëmbejmë përvojat tona dhe t’i ndajmë njohuritë së bashku për gjatë këtyre ditëve. I përgëzoj pjesëmarrësit për angazhimin, dhe jam i sigurt, që gjitha këto mësimë që u ligjëruan gjatë këtyre ditëve, do ju shërbejnë të gjithëve gjatë përditshmërisë së tyre në të ardhmen”.

Ndërsa në emër të instruktorëve amerikanë, foli Cris Addigton, i cili ishte mjaft falënderues

për bashkëpunimin me institucionin e FSK-së. Ai ndër tjerash shtoi: „Ndërtimi i marrëdhënieve të mira ndërkombëtare ka një rëndësi të veçantë për të ecur përpara, pasi që, ne asnjëherë nuk do luftojmë të vetëm, dhe ky bashkëpunim do na ndihmojë të gjithë neve në të ardhmen”.

Gjatë këtij seminary, instruktorët shtjelluan tema nga më të ndryshmet të cilat do u ndihmojnë nënoficerëve gjatë karrierës së tyre ushtarake, si: Roli i nënoficerit në ushtri, Marrëdhënia e oficerit me nënoficerin, Ndërtimi i marrëdhënieve pozitive, Mësimdhënia, Identiteti i shërbimit e luftimi së bashku, Rolet ndërkombëtare etj. Në fund të ceremonisë të gjithë të pranishmëve ju dhanë certifikata për pjesëmarrje në trajnim.

Stoltenberg: Për Maqedoninë Veriore tani ka një vend në tryezën e NATO-s

Ministrja e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut, zonja Radmilla Shekerinska është ministrja e pare e Maqedonisë së Veriut në Bruksel në takimin formal të Ministerialit të Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s që u zhvillua në datat 13 dhe 14 shkurt 2019. Në fillimi i takimit, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg përshëndeti ministren Shekerinska dhe shprehu kënaqësinë që ajo mori pjesë në takimin ministror. Jam jashtëzakonisht i kënaqur që në këtë takim do të mirëpresim për herë të parë kolegen tonë nga Shkupi, ministren Radmilla Sekerinska. Republika e ardhshme e Maqedonisë Veriore tani ka një vend në tryezën e NATO-s”, tha Stoltenberg. „Ky është një moment i mrekullueshëm për të gjithë ne. Ne e vlerësojmë me të vërtetë përpunimin që keni bërë dhe pa angazhimin tuaj personal, përkushtimin ndaj udhëheqjes suaj dhe qeverisë suaj, nuk do të ishim në gjendje t’ju kishim këtu, domethënë t’ju ftojme në këtë takim ministror. Kjo është një ditë e mrekullueshme dhe mezi pres ditën kur do të jeni anëtar i plotë, pasi procesi i ratifikimit të protokollit të pranimit të përfundohet nga të gjithë 29 aleatët”, tha sekretari i përgjithshëm Stoltenberg.

„Ky është një moment historik për ne dhe për Aleancën. Së bashku kemi kaluar nëpër shumë sfida. Së bashku, ne mbetemi të vendosur për të mbrojtur lirinë, trashëgiminë e përbashkët të popujve tanë, bazuar në parimet e demokratizimit, lirive individuale dhe sundimit të ligjit”, tha Shekerinska para ministrave të mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s. Duke cituar Uinston Çurçilin, ministrja tha se jemi të



vetëdijshëm se ky është “fundi i fillimit” dhe se ne jemi të gatshëm për t’u përballur me sfidat e reja. Ajo tha se atdheu ynë ka qenë partner i Aleancës për shumë vite dhe në ato vite kemi treguar se jemi të besueshëm, të përkushtuar dhe fleksibël. “Si anëtare e plotë, Aleanca mund të na llogarisë si të aftë dhe të gatshëm për të kontribuar në misionin kolektiv mbrojtës dhe të mbrojtjes së vlerave tona të përbashkëta demokratike”, shtoi ministrja. Shekerinska theksoi se buxheti i mbrojtjes është në rritje, në përputhje me udhëzimet e Aleancës për ndarjen e 2 përqind të produktit të brendshëm bruto, dhe se ne jemi në fazën e zbatimit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes. Ajo shtoi se Armata është e angazhuar të jetë pjesë proaktive e strukturave dhe misionëve të Aleancës dhe se reformat janë në rrjedhë për të zhvilluar forca ushtarake të ndërveprueshme si pjesë e aleancës më të suksesshme të

mbrojtjes në botë.

“Maqedonia pas tre dekadash beteje për vendin e saj në Aleancë, arrin të ulet në të njëjtën tryezë me të gjithë aleatët e Aleancës dhe kjo është një ditë krenarie, jo vetëm për mua si ministre e parë i mbrojtjes, por është nder dhe krenari për të gjithë qytetarët e vendit tonë”, tha ministrja.

„Dyert e hapura për Republikën e Maqedonisë Veriore në NATO janë dëshmi se Aleanca është një institucion dinamik që shikon drejt së ardhmes dhe mund të trajtohet me sfidat e mbrojtjes sot si dhe 70 vjet më parë. Republika e Maqedonisë Veriore është me ju. Pres me padurim të ardhmen tonë të përbashkët,” përfundoi ministrja Shekerinska.

Gjatë zhvillimit të Ministerialit dy ditor në Bruksel, ministrja Shekerinska është takuar me ministrat e mbrojtjes të Bullgarisë, Greqisë, Turqisë, Belgjikë, Kanadasë, Britanisë së Madhe.

Më 5 shkurt ministrja e Mbrojtjes e Maqedonisë, Radmilla Shekerinska ka pritur në takim zyrtar zëvendës kryeministrin dhe ministrin e mbrojtjes të Kroacisë, Damir Krstiçeviq.

„Në shembullin e Kroacisë, pamë se si anëtarësimi në NATO pozitivisht ndikoi jo vetëm në stabilitetin, por edhe në të gjitha proceset politike dhe sa kjo e mbështeti procesin e pranimit në BE. Republika e Maqedonisë, për një vit e gjysmë arriti të kompensojë kohën dhe mundësinë e humbur. Por për këtë një vit e gjysmë ambiciet tona janë rritur gjithashtu. Duke kërkuar mbështetje për anëtarësimin në NATO, sot dhe në të ardhmen do të kërkojmë mbështetje për fillimin e negociatave me BE dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian,” tha ministrja Shekerinska dhe shprehu mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme dhe shumë të qartë kroate. “Kolegë Damir, shihemi së shpejti në NATO”, i tha ministria ministrit kroat të mbrojtjes. Ministria gjithashtu u falënderua për mbështetjen që ambasada kroate në Maqedoni si ambasada kontakti e NATO-s në vitin 2017 dhe 2018 i dha Maqedonisë dhe shprehu shpresën se Kroacia shpejt do të mbështesë anëtarësimin e Maqedonisë në NATO edhe përmes ratifikimit të Protokollit për Anëtarësim. Ministri Damir Krstiçeviq theksoi se dy vendet kanë bashkëpunim të shkëlqyer dhe afatgjatë të mbrojtjes, veçanërisht në fushën e trajnimit dhe arsimit dhe shprehu gatishmërinë e tyre për ta zhvilluar atë në fushën e reformave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe ARM-së, shkëmbimit të përvojave në mbështetje të popullatës në rast të fatkeqësive natyrore, si dhe në bashkëpunimin në pjesën e organizimit, pajisimit dhe trajnimit të njësisve speciale. Ai duke rikujtuar se Kroacia dhe Maqedonia janë shtete mike tha se bashkëpunimi mund të vazhdojë edhe në industrinë e mbrojtjes. “Kroacia ka industri të jashtëzakonshme mbrojtëse dhe shohim potencial të madh për një bashkëpunim të ardhshëm në sferën e industrisë së mbrojtjes. Të gjitha marrëdhëniet mes dy

Kroacia ka industri mbrojtëse dhe potencial për bashkëpunim



ministrive dhe dy shteteve janë për avancimin e paqes dhe sigurisë në Evropën Juglindore dhe për këtë kapacitet të plotë për bashkëpunim”, theksoi Krstiçeviq. Maqedonia dhe Kroacia bashkëpunojnë gjithashtu në iniciativat rajonale si SHBA-Karta

e Adriatikut, SEDM, RACVIAC, si edhe në misionet ndërkombëtare, në veçanti misionin “Mbështetje e Vendosur” në Afganistan-Komanda e Veriut, ku së bashku kontribuojnë në vendosjen e paqes dhe demokracisë në këtë vend.

ARM KA MBËSHTETJEN E KFOR-IT

Gjeneralmajor Gjurcinovski vizitë në komandën e KFOR-it

Një delegacion i ushtrisë maqedonase (ARM), të udhëhequr nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm Gjeneral Major Vasco Gjurcinovski, më 2 shkurt realizoi një vizitë të planifikuar rregullisht në komandën e KFOR-it në Prishtinë. Gjatë vizitës, gjeneral Gjurcinovski u takua dhe zhvilloi bisedime me komandantin e KFOR-it, Gjeneral Major Lorenzo D’Addario. Në takimin e planifikuar vjetor në Prishtinë u diskutua gjendja e sigurisë dhe kërcënimet ndaj sigurisë në rajon, me theks të veçantë në aktivitetet që kanë të bëjnë me krizën e emigrantëve. Gjeneralët Gjurcinovski dhe D’Addario theksuan bashkëpunimin e mirë të ARM-së me KFOR-in si të rëndësishëm për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në rajon dhe diskutuan mundësitë për bashkëpunim të mëtejshëm.

ARM ka siguruar mbështetjen e KFOR-it për tranzitimin e procedurave doganore dhe procedurave kufitare, përdorimin e kapaciteteve në evakuimin mjekësor të ushtrisë në rast nevojë, shërbime në fushën logjistike, etj. Ky kontribut i Republikës së Maqedonisë është i rëndësishëm dhe i vlerësuar siç duhet nga komanda e NATO-s për Forcën e Përbashkët në Napoli, nën komandën e të cilit janë vendosur forcat paqeruajtëse të KFOR-it. Takimet e rregullta të drejtuesve të lartë të ARM-së dhe KFOR-it, të mbajtura çdo vit, janë të një rëndësie të veçantë për situatën e sigurisë rajonale.

Ministeriali i NATO-s: Bruksel, 13-14 shkurt 2019

Stoltenberg: NATO nuk do garë armatimesh

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s u takuan në Bruksel këtë javë, në datat 13 dhe 14 shkurt 2019, në një kohë kritike për sigurinë transatlantike. Në konferencën për shtypin (12 shkurt) përpara takimit dy-ditor, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg tha se do ketë diskutime të rëndësishme mbi Traktatin e Forcave Bërthamore të Mesme (INF), mbrojtjen e NATO-s dhe qëndrimin parandalues, misionet dhe operacionet e NATO-s dhe bashkëpunimin evropian në mbrojtje. "Rusia vazhdon të shkelë Traktatin e INF-it duke vendosur raketa të reja të mundshme bërthamore të ndërmjetme, raketat SSC-8. Këto raketa të lëvizshme është vështirë të zbulohen dhe mund të arrijnë qytetet evropiane. Ne do të vazhdojmë t'i bëjmë thirrje Rusisë që të kthehet tek Traktati INF. Do të diskutojmë misio-

net dhe operacionet e NATO-s në Afganistan, në Irak dhe në Kosovë. Mirëpres ministren e Mbrojtjes Radmila Sekerinska, që përfaqëson Republikën e Maqedonisë Veriore, si e ftuar në takimin e ministrave të Mbrojtjes të NATO-s për herë të parë", tha Stoltenberg.

Rusia ka gjashtë muaj kohë të kapë mundësinë e fundit

Takimi të mërkurës filloi me diskutime mbi të ardhmen e Traktatit të INF dhe shkeljes së vazhdueshme të dispozitave të tij nga Rusia. Takimi i bëri thirrje Rusisë të kapë mundësinë e fundit për tu "kthyer në pajtueshmëri dhe për të shpëtuar Traktatin e INF". Ndërkohë që Moskë vazhdon të zhvillojë dhe të vendosë disa batalione të raketave SSC-8, përkundër përpjekjeve të Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të tjerë të NATO-s, për shumë vite, për të inkurajuar Rusinë që të kthehet në pajtim. "Ne të gjithë e dimë se një traktat që respektohet vetëm nga njëra anë nuk mund të na mbajë të sigurt. Kjo është arsyeja pse Shtetet e Bashkuara, me mbështetjen e plotë të të gjithë aleatëve të NATO-s, kanë njoftuar synimin e tyre për t'u tërhequr nga Traktati". Ne i bëjmë thirrje Rusisë që ta shfrytëzojë këtë mundësi". Në takimin e ministrave të Mbrojtjes, u diskutua se çfarë hapash do të ndërmarrë NATO për t'iu përshtatur një bote me më shumë raketa ruse dhe të mbajë parandalimin efektiv dhe mbrojtjen si dhe çdo hap që aleatët do të ndërmarrin do të koordinohet, matet dhe do të jetë mbrojtës. "Ne nuk synojmë të vendosim raketa të reja bërthamore në Evropë, në të njëjtën kohë, ne mbetemi të angazhuar në kontrollin e armëve kuptimplotë dhe përpjekjet për mospërhapjen e armëve". NATO nuk dëshiron një garë të re të armëve sepse kjo do të ishte në interesin e askuj, ata gjithashtu "diskutuan më gjerë për parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s", duke përfshirë punën për "Iniciativën e Gatishmërisë së re". Kjo do të shtojë gatishmërinë me 30 anije luftarake, 30 batalione toke dhe 30 skuadra ajrore, të



disponueshme brenda 30 ditëve. Por dialogu me Rusinë do të vazhdojë, “është me rëndësi të kemi dialog me Rusinë posaçërisht kur përballemi me kaq shumë çështje të vështira me të cilat ballafaqohemi so, me tensionet në rritje, me shkeljen e Traktatit të INF”, prandaj ka rëndësi dialogu me Rusinë “në nivele të ndryshme”. NATO ka thënë në mënyrë të përsëritur se nuk ka plane për të vendosur raketa bërthamore të ndërmjetme në Evropë. “Për shkak se procesi i tërheqjes nuk do të përfundojë deri në gusht, kështu që ekziston një dritare gjashtë mujore për Rusinë që të kthehet në përputhje dhe ne vazhdojmë të nxisim Rusinë që të kthehet në përputhje me traktatin. Në të njëjtën kohë, po planifikojmë për një të ardhme pa Traktatin e INF dhe me më shumë raketa ruse”, dhe në këtë çështje “shumë serioze, ne do të marrim kohën tonë”, por ajo që është e rëndësishme është se përgjigjja e Aleancës “do të jetë e bashkuar, Aleatët e NATO-s do të veprojnë së bashku”, sepse NATO nuk do një garë të re të armëve dhe “nuk ka ndonjë qëllim për të vendosur sisteme të reja armë bërthamore në Evropë”, por NATO ndërkohë “ka një sërë opsionesh të tjera konvencionale”. Ajo ka qenë e bashkuar në çështjen INF gjatë shumë, shumë viteve, që datojnë në vitet shtatëdhjetë. Po ashtu edhe në vitin 1987, kur të gjithë aleatët e NATO-s mbështesnin Traktatin e INF-it që ndalon të gjitha armët INF, të gjitha armët e ndërmjetme. Po ashtu NATO ka qenë e bashkuar edhe kur administrata Obama, gati 6 vjet më parë, ngriti shqetësimet e saj rreth shkeljes ruse të traktatit, apo në dhjetor të vitit të kaluar, ku të gjithë aleatët ranë dakord, bazuar edhe në inteligjencën e mbledhur, se Rusia është në kundërshtim me traktatin, po kështu edhe në fillim të shkurtit, kur SHBA njoftoi se do të fillonte procesin e tërheqjes nëse Rusia nuk kthehet në përputhje. Nga ana e saj Moskë akuzon Uashingtonin me tre shkelje të Traktatit të INF lidhur me raketat MK-41. Por “përpjekjet e Rusisë për t’u përqëndruar në Sistemin e Mbrojtjes së Raketave të NATO-s janë e vetmja mënyrë që përpiqet të shpëtojë vëmendjen nga çështja reale dhe çështja e vërtetë është se Rusia po vendos raketat e reja bërthamore në Evropë. Nuk ka raketa të reja amerikane në Evropë; por në Evropë ka gjithnjë e më shumë raketa të reja ruse, me aftësi për bërthamore. Kjo është arsyeja pse traktati i INF tani është në rrezik të vërtetë dhe gjithashtu arsyeja pse ne vazhdojmë t’i bëjmë thirrje Rusisë që të kthehet në pajtim në këtë periudhë gjashtëmujore, kur ata ende mund ta bëjnë këtë, duke e ruajtur Traktatin që do të jetë rëndësi të madhe për të gjithë ne”.

Shpenzimet e Mbrojtjes

Ndarja e shpenzimeve dhe shpenzimet e mbrojtjes ishin në agjendën e takimit të ministarve të Mbrojtjes në Bruksel, ndërkohë që të gjithë aleatët kishin dorëzuar raportet e tyre vjetore në planet e tyre kombëtare për të përmbushur premtimin për investime në mbrojtje. Shqyrtimi i përparimit ishte në të tre dimensionet e premtimit: paratë, aftësitë dhe kontributet. “Në të tre masat, tendenca është rritur. Që nga viti 2016, aleatët evropianë dhe Kanadaja kanë shpenzuar 41

miliardë dollarë më shumë për mbrojtjen dhe bazuar në raportet e fundit, kjo do të rritet deri në njëqind miliardë dollarë deri në vitin e ardhshëm”, tha Stoltenberg. Aleatët po investojnë më shumë në aftësitë moderne duke kontribuar me më shumë forca në misionet dhe operacionet e NATO-s. “Ne ende kemi punë për të bërë, por unë jam i inkurajuar nga progresi i rëndësishëm deri tani”. Gjithashtu shumica e aleatëve kanë paraqitur plane për të arritur 2 përqind deri në vitin 2024. “E mirëpres faktin se edhe ata aleatë që ende nuk kanë paraqitur plane për të arritur 2 përqind, ata kanë filluar të rriten, pra, ata po lëvizin shumë në drejtimin e duhur dhe kjo përfshin Gjermaninë. Ne shohim një rritje të konsiderueshme në shpenzimet e mbrojtjes gjermane”. Plani aktual gjerman përshkruan shpenzimin në një rritje prej 80 përqind në investimet e mbrojtjes deri në vitin 2024 dhe kjo është e rëndësishme, për shkak se Gjermania është një ekonomi e madhe kur bëhet fjalë për shpenzimet totale të mbrojtjes midis aleatëve evropianë të NATO-s. “Gjë e mirë është se të gjithë aleatët kanë ndaluar shkurtimet pas viteve të shkurtimit të buxheteve të mbrojtjes. Të gjithë aleatët kanë ndaluar shkurtimet dhe të gjithë aleatët tanë tani janë duke rritur investimet në mbrojtje”.

Operacionet dhe Misionet e NATO-s

Dita e dytë e takimit, e enjte 14 dhjetor 2019, u përqëndrua në misionet dhe operacionet e NATO-s, përfshirë Afganistanin, Kosovën, Irakun dhe operacionet detare. “Në Afganistan, situata mbetet e vështirë, por ne gjithashtu shohim përpjekje për paqe. Aleatët janë përditësuar nga afër nga Shtetet e Bashkuara. Ne vazhdojmë të konsultohemi për implikimet e një marrëveshjeje të mundshme paqësore dhe se si NATO mund ta mbështesë atë”, dhe për këtë takimet me ambasadorin e SHBA Khalilzad, kanë qenë të shpeshta, madje “është hera e tretë në javët e fundit që takohemi me të, është shumë herët për të thënë nëse do të ketë një marrëveshje”. NATO vazhdon të ndihmojë forcat afgane të sigurisë të krijojnë kushtet për një zgjidhje paqësore, por ajo që është e qartë është se aleatët shkuan së bashku në Afganistan dhe së bashku do të përcaktojnë sjelljen e ardhshme, bazuar në kushtet që do përcaktojnë me afganët. Prezenca ushtarake e NATO-s në Afganistan ka të bëjë me sigurimin, krijimin e kushteve për një zgjidhje politike dhe paqësore dhe qëllimi natyrisht që nuk është “në Afganistan përgjithmonë. Por NATO mbështet fuqimisht përpjekjet për të arritur një zgjidhje politike dhe paqësore. “Prandaj ne jemi në kontakt të ngushtë me të dërguarin e posaçëm të SHBA, ambasadorin Khalilzad. Ai i ka informuar Aleatët e NATO-s tri herë gjatë javëve të fundit lidhur me përpjekjet për të arritur një marrëveshje me talebanët”. Aleatët e NATO-s ishin së bashku në Afganistan dhe “vendimet mbi qëndrimin e ardhshëm në Afganistan do të merren së bashku, bazuar në kushtet e vendosura së bashku me afganët”, në mbështetje të përpjekjeve për paqe. Qëllimi i NATO-s në Afganistan është “të luftojë terrorizmin dhe të krijojë kushtet për një zgjidhje paqësore, duke ndihmuar, trajnuar dhe mbështetur forcat afgane të sigurisë.

Kurse në Irak, NATO ka misionin e saj të ri. Mbështetja e Aleancës do të ndihmojë Irakun të parandalojë ringjalljen e ISIS ose grupeve të tjera terroriste. NATO ka adresuar gjithmonë luftën kundër terrorizmit, "situata në Siri është e rëndësishme, NATO nuk është e pranishme në terren në Siri, por janë disa aleatë të NATO-s" si për shembull, përpjekjet e Turqisë dhe Shteteve të Bashkuara në Sirinë veriore.

Çështja tjetër e trajtuar ishte ajo lidhur me misionin e KFOR-it të NATO-s në Kosovë, i cili ka dhënë një kontribut të rëndësishëm për stabilitetin në rajonin e Ballkanit Perëndimor për 20 vitet e fundit. Ka pasur disa deklarata lidhur me këtë temë por Forcat e Sigurisë së Kosovës nuk mund të shkojnë në veri pa lejen e KFOR-it, edhe pse Kryeministri Haradinaj tha se forcat e sigurisë mund të shkojnë si në veri apo jugi të Kosovës. Por ka një marrëveshje, "Marrëveshjen e Brukselit të 2013 duke deklaruar qartë se Forcat e Sigurisë së Kosovës nuk mund të shkojnë në veri pa dakordësinë e komandantit të KFOR-it, COMKFOR-it", dhe "kjo marrëveshje është ende e vlefshme, ende zbatohet dhe kjo është gjithashtu diçka që thuhet qartë nga shumë aleatë". NATO do të mbetet në Kosovë me KFOR-in, sepse KFOR-i bazohet në mandatin e OKB-së dhe prania e KFOR-it, është dhe ka qenë e rëndësishme për stabilitetin në Kosovë dhe në të gjithë rajonin. Ajo që vlerësohet është prania e NATO-s, "aktivitetet tona jashtë misionit të KFOR-it. Ne kemi lloje të ndryshme të mbështetjes për ndërtimin e kapaciteteve për Forcat e Sigurisë së Kosovës, të cilat nuk janë pjesë e misionit të KFOR-it, por janë aktivitete të NATO-s jashtë saj", randaj trajtimi në nivelin e këtij angazhimi bazuar në faktin se shumë aleatë besojnë se vendimi për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në një ushtri të Kosovës ishte e pa matur dhe për këtë arsye ka një rëndësi të veçantë.

Bashkëpunimi NATO-BE

Një sesion i përkushtuar ndaj bashkëpunimit NATO-BE dhe përpjekjeve të BE-së për mbrojtjen, ishte ai në takimim e ministrave të Mbrojtjes të NATO-s. "Bërë në mënyrë të drejtë, përpjekjet e BE-së mund të forcojnë shtyllën evropiane në NATO dhe të çojnë në ndarjen më të drejtë të barrës. Por sigurisht, përpjekjet e BE-së për mbrojtjen nuk mund ta zëvendësojnë NATO-n. Pra, duhet të sigurojmë që përpjekjet tona të plotësojnë dhe të mos konkurrojnë me njëri-tjetrin" dhe takimi me Përfaqësuesin e Lartë të BE-së Mogherini tregon për një bashkëpunim midis NATO-s dhe BE. Nukka kontraktë midis përpjekjeve të BE-së për mbrojtjen dhe një NATO-je të fortë. Përpjekjet e BE-së "do të forcojnë shtyllën evropiane në NATO, Fondi Evropian i Mbrojtjes, do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive të reja, do të ndihmojnë në rritjen e investimeve të mbrojtjes, ato do të ndihmojnë në adresimin e fragmentimit të industrisë së mbrojtjes evropiane. E gjithë kjo do të forcojë aleatët evropianë të NATO-s". BE-ja kurrë nuk mund ta zëvendësojë NATO-n "kur bëhet fjalë për mbrojtjen kolektive dhe mbrojtjen e Evropës". Rritja e bashkëpunimit në mes të aleatëve evropianë në NATO, si ushtrimet dhe zhvillime të aftësive

tregojnë për një punë të përbashkët të anëtarëve të BE-së jo-NATO-s, si Suedia dhe Finlanda që kanë moarrë pjesë, në Trident Juncture apo Trug Junction që është një ushtrim i madh i NATO-s dhe që kanë sjellë së bashku aleatët evropianë, shumica e tyre anëtarë të BE-së, që janë ushtruar së bashku. NATO nxit shumë bashkëpunime evropiane dhe PESCO dhe përpjekjet e tjera të BE-së për mbrojtjen mund të forcojnë vetëm shtyllën evropiane të NATO-s. "Është e rëndësishme që ne duhet të shmangim çdo perceptim që Evropa mund të menaxhojë pa NATO-n, sepse dy luftëra botërore dhe Lufta e Ftohtë na mësojnë se ne kemi nevojë për një lidhje të fortë transatlantike për të ruajtur paqen dhe stabilitetin në Evropë dhe sidomos pas Brexit, është e qartë se përpjekjet e BE-së nuk mund të zëvendësojnë NATO-n, sepse pas Brexit, 80 përqind e shpenzimeve të mbrojtjes të NATO-s do të vijnë nga anëtarë të BE-së. Kjo është pjesërisht për para, por edhe pjesërisht për gjeografinë. Norvegjia në veri, jo një aleat shumë i madh, por i rëndësishëm kur bëhet fjalë për veriuin e lartë. Turqia në jug, shumë e rëndësishme në luftën kundër terrorizmit dhe pastaj në përfundim do të kenë aleatë të mëdhenj si Kanadaja, Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar.

70 vjetori i NATO-s dhe 10 vjetori i hyrjes të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Aleancë

"Jam jashtëzakonisht i kënaqur që në këtë takim do të mirëpresim për herë të parë kolegen tonë nga Shkupi, ministren Radmilla Sekerinska. Republika e ardhshme e Maqedonisë Veriore tani ka një vend në tryezën e NATO-s", do të shprehte kënaqësinë e tij Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Stoltenberg. Por gjithashtu kyvit do të shënojë 70 vjet të krijimit të NATO-s, por do të shënojë gjithashtu edhe 10 vitet e vendeve të para të Ballkanit Perëndimor që kanë hyrë në Aleancë. Shqipëria dhe Kroacia u bashkuan në 2009, Mali i Zi në vitin 2017 dhe "në rrugën e mirëpritjes është gjithashtu Republika e Maqedonisë Veriore si anëtar i 30-të". Zgjerimi me anëtarët nga Ballkani Perëndimor ka forcuar NATO-n, por gjithashtu ka ndihmuar për të stabilizuar Ballkanin Perëndimor dhe "për të ndihmuar në forcimin e atyre vendeve në rajon që janë bashkuar me NATO-n, si Mali i Zi dhe tani dhe Republika e Maqedonisë Veriore. "Duhet të kujtojmë se jo shumë vite më parë, në vitet 1990 dhe madje edhe në fillim të vitit 2000, pamë konflikte të armatosura, pamë mizori, pamë luftëra në Ballkanin Perëndimor, në Bosnjë e Hercegovinë, në Kosovë, Serbi. Ne gjithashtu panë një situatë vërtet të rrezikshme në atë që e quajtmë ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, e cila tani do të jetë Republika e Maqedonisë Veriore. NATO ka luajtur një rol kyç në zgjidhjen e këtyre konflikteve, duke i dhënë fund luftërave dhe duke ndihmuar në stabilizimin". Ekzistojnë shumë sfida, ende shumë probleme, por "është jashtëzakonisht inkurajuese të shohim se kemi anëtarë si Sllovenia, si Kroacia, si Shqipëria, por edhe tani, kohët e fundit, Mali i Zi dhe Republika e Maqedonisë Veriore".



Me rastin e 575 VJETORIT Kuvendi i Lezhës, ngjarje madhore në historinë kombëtare shqiptare



PROF. ASOC. DR.
BERNARD ZOTAJ

Në plan të parë bashkimi i forcave politike-ushtarake

Lufta e madhe shqiptaro-osmane nën udhëheqjen e Skënderbeut shpejtoi zhvillimin e një procesi të ligjshëm dhe shumë të rëndësishëm, sikurse ishte bashkimi i vendit në një shtet të vetëm e të përqëndruar. Kapërcimi i copëzimit feudal dhe krijimi i formacioneve shtetërore të përqëndruar ishte një dukuri që ndeshet në periudhën e feudalizmit të zhvilluar. Në këtë kohë pushteti qendror, i mbështetur në përkrahjen e qyteteve, thyen partikularizmin feudal dhe i hap rrugë formacioneve politike më të mëdha, brenda të cilave mund të lëvizin forcat shoqërore të interesuara për zhvillimin dhe përparimin e mëtejshëm të vendit. Jo vetëm Shqipëria, por gjithë zona Adriatiko-Balkanike në shek. XV kishte arritur një zhvillim të tillë të brendshëm që çonte

objektivisht në likuidimin e përçarjes feudale dhe në formimin e shteteve të përqëndruara. Në Shqipëri ky proces objektiv ishte penguar për një kohë të gjatë nga pushtuesit e huaj, por lufta e madhe e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut krijoi mundësi të reja për zgjidhjen, qoftë edhe jo të plotë, të kësaj detyre historike, që ishte përgatitur nga i gjithë zhvillimi i mëparshëm i vendit.

Mbas kryengritjes kundër regjimit të timareve, problemi kryesor në plan kombëtar ishte bashkimi i forcave politike-ushtarake dhe ekonomike të vendit në një front të vetëm e të përbashkët antiosman. Për këtë bashkim ishin të interesuara në radhë të parë masat popullore, mbi të cilat binte gjithë pesha e shtypjes dhe e shfrytëzimit osman. Edhe feudalët shqiptarë ishin të bindur tashmë nga përvoja e tyre se, duke qëndruar të shkëputur nga njeri-tjetri, nuk mund të ndalonin pushtimin e vendit nga ushtritë osmane dhe humbjen e zotërimeve të tyre feudale. Për zgjidhjen e detyrës historike të bashkimit të popullit shqiptar dhe të klasës feudale në një front të vetëm antiosman, Skënderbeu organizoi mbledhjen e një kuvendi të përgjithshëm kombëtar. Ky kuvend ka hyrë në histori me emrin "Kuvendi i Lezhës". Për këtë qëllim në mënyrë paraprake u zhvilluan një sërë konsultime me feudalë shqiptar dhe krenrë e tjerë të vendit për përgatitjen e kuvendit dhe largimin e pengesave në rrugën e bashkimit.

Kuvendi u mbledh më 2 mars 1444 në qytetin e Lezhës që ishte nën sundimin e Venedikut. Thirrja e kuvendit

në qytetin e Lezhës kishte për qëllim të evitonte çdo keqkuptim midis pjesëmarrësve, lidhur me respektimin e ndereve feudale. Nga ana tjetër siguronte përkrahjen ose të paktën neutralitetin e Venedikut në luftën e madhe shqiptaro-osmane. Për këtë qëllim u ftua të merrte pjesë në punimet e kuvendit Republikat e Venedikut dhe të Raguzës. Kuvendi i Lezhës mbledhej mbi bazën e traditëve më të hershme shqiptare, për t'i trajtuar problemet e rëndësishme në kuvende të përbashkëta. Kuvendi i mbledhur dhe i organizuar nga Skënderbeu, shënonte zhvillim të mëtejshëm të traditave, sepse ishte një kuvend në shkallë kombëtare. Në punimet e Kuvendit të Lezhës morën pjesë përfaqësuesit e familjeve më të fuqishme feudale shqiptare. Sundimtarë të principatave feudale ishin të pranishëm në kuvend, të shoqëruar nga djemtë ose nga nipërit e tyre. Në të morën pjesë dhe feudalët më të vegjël, si dhe krerë të tjerë, të cilët përfaqësonin fshatarësinë e lirë të malësive të Shqipërisë.

Bashkëkohësi dhe historiani i Skënderbeut, humanisti shqiptar Marin Barleti, në veprën "Historia e Skënderbeut" na përshkruan emrat e sundimtarëve shqiptarë që morën pjesë në punimet e kuvendit. Midis tyre ishte nismëtari dhe organizuesi i kuvendit, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, si përfaqësues i principatës së Kastriotëve, Gjergj Araniti, Andrea Topia me dy djemtë, Komini dhe Muzaka me të nipin Tanush Topia, Gjergj Stres Balsha, Tedor Korona Muzaka me të tjerë nga familja e Muzakajve, Pal dhe Nikollë Dukagjini, Lekë Zaharia, Pjetër Spani me katër djemtë, Lekë Dushmani së bashku me disa feudalë më të vegjël pranë principatës së tij, etj. Pjesëmarrësit në kuvend u mblodhën nga trevat ku flitej gjuha shqipe. Përjashtim bënte vetëm Stefan Cernojeviçi, sundimtar i Zetës (Malit të Zi), që kishte zotërimet e veta pranë liqenit të Shkodrës me një popullsi të madhe shqiptare, por dhe lidhje familjare me Skënderbeun, se ishte martuar me njerën nga motrat e tij.

Në Kuvendin e Lezhës mori pjesë dhe përfaqësuesi i Venedikut me cilësinë e vëzhguesit. Republika e Raguzës refuzoi të merrte pjesë për të mos ndërlikuar marrëdhëniet e saj me Sulltanin e Perandorisë Osmane. Kuvendi i Lezhës mbas diskutimeve të shumta, mori vendime të rëndësishme, të cilat përcaktuan natyrën politike të këtij kuvendi. Me gjithë divergjencat e diktuara nga interesat e ngushta, feudalët e mbledhur në kuvend u shprehën për bashkimin e tyre në luftë kundër pushtimit osman.

Skënderbeu, kryeprijësi i Shqipërisë

Ideja e bashkimit të gjitha forcave politike, ushtarake dhe ekonomike të vendit në një front të përbashkët u konkretizua në mjaft vendime të tij. Më i rëndësishmi midis tyre ishte vendimi për krijimin e një besëlidhjeje të feudalëve shqiptarë, e që mori emrin "Lidhja e princave shqiptarë" (Lidhja e Lezhës). Skënderbeu si organizator dhe udhëheqës i kryengritjes çlirimtare kundër regjimit të timareve, si dhe për shkak të pozitës së rëndësishme që kishte principata e Kastriotëve u zgjodh njëzëri kryetar i saj. Barleti na jep informacion të pasur mbi Kuvendin e Lezhës dhe vendimet e tij. Ai thotë se Skënderbeu "vendosi para së gjithash, se duhej hyrë në aleancën dhe në një farë besëlidhjeje të përhershme me princërit dhe sundimtarët fqinj...". Dhe mandej, pasi përshkruan zhvillimin e punimeve të këtij kuvendi, thekson se të gjithë "... pasi ia kaluan gati si me dorë pushtetin, popujt, ushtritë dhe pasi i besuan drejtimin suprem të të gjithë gjendjes dhe kujdesin e luftës,



e zgjodhën kryetar dhe kapedan të tyre të vetëm".

Skënderbeu, megjithëse kryetar dhe Komandant i Përgjithshëm, ishte në këtë kohë një "i parë midis të barabartëve". Sidoqoftë, caktimi i një udhëheqësi të vetëm politik e ushtarak kishte një rëndësi të madhe dhe ishte një hap përpara në kapërcimin e përçarjes feudale. Të dhënat që na sjell Barleti konfirmohen dhe plotësohen me kujtimet e bujarit shqiptar Gjon Muzaka, bashkëkohës i Skënderbeut nga familja e Muzakajve. Ai shkruan: "pastaj këta sundimtarët e Shqipërisë u mblodhën në Kuvend në Lezhë. Dikush shkoi vet, dikush çoi mëkëmbës. Kështu që Skënderbeu i lartpërmendur u bë kryeprijës në Shqipëri, dhe secili dërgonte njerëz dhe të holla sipas sasisë që i takonte. Po kështu edhe disa bij të atyre sundimtarëve luftonin nën drejtimin e tij, edhe për të mësuar mjeshtërinë e luftës, edhe për të mbrojtur shtetet e veta. Duke qenë ai zotëri fort i rrahur në luftë dhe fatos, u zgjodh kryeprijës dhe secili i bindej". Pjesëmarrja në lidhje për çdo feudal garantonte të drejtën e mbrojtjes nga pushtuesi, si dhe detyrimin për të kontribuar në krijimin e ushtrisë dhe të mjeteve financiare të përbashkëta. Me këto detyrime lidhen dy vendime të rëndësishme të Kuvendit të Lezhës: vendimi për krijimin e një ushtrie të "Lidhjes së princave shqiptarë" si dhe sigurimin e mjeteve financiare për shpenzimet e luftës me forca të përbashkëta.

Kuvendi i Lezhës vendosi të krijonte një ushtri shqiptare, e cila do të rekrutohej nga Skënderbeu në principatën e Kastriotëve si dhe nga feudalët e tjerë në zotërimet e tyre. Secili anëtar i lidhjes përcaktoi vullnetarisht numrin e ushtarëve me të cilët do të kontribuonte në krijimin e ushtrisë së përbashkët. Skënderbeu u zgjodh komandant i përgjithshëm i ushtrisë së Lidhjes, kurse komandantët e reparteve do të emëroheshin nga vetë bujarët.

Për të përballuar shpenzimet e luftës, Kuvendi i Lezhës vendosi krijimin e një fondi të posaçëm në të holla, i cili do të sigurohej pjesërisht me kontributin e feudalëve shqiptarë dhe pjesërisht nga të ardhurat e kriporeve të Shën Kollit në veri të Durrësit, të cilat u përkisnin Kastriotëve. Mjetet financiare, si dhe ushtria do të administroheshin nga Skënderbeu, i cili jepte për çështjen e luftës çlirimtare kontributin kryesor midis bujarëve të tjerë në ushtarë dhe të holla. Skënderbeu u ngarkua nga Kuvendi i Lezhës me detyra të shumta drejtuese dhe komanduese. Në këtë mënyrë ai merrte përgjegjësinë kryesore për zhvillimin e luftës.

Skënderbeu dhe bujarët shqiptarë

Nga pikëpamja strategjike "Lidhja e princave shqiptarë" përbënte aleancën politik-ushtarake (besëlidhje) më të fuqishme midis bujarëve shqiptarë me njeri-tjetrin për mbrojtjen e zotërimeve të tyre feudale me forca të përbashkëta. Në zotërimet e tyre, bujarët shqiptarë pjesëmarrës ishin zotër të pavarur dhe mbajtës të çdo pushteti. Me gjithë rolin udhëheqës dhe komandues të Skënderbeut në "Lidhjen e princave shqiptarë", pozita e tij drejtuese në vitet e para të ekzistencës së saj, nuk ishte ajo e një monarku, por e një drejtuesi ushtarak. Udhëheqja e tij përmblihet vetëm në organizimin e mbrojtjes së vendit, pa cënuar privilegjet e feudalëve të veçantë dhe pushtetin e tyre brenda zotërimeve të veta. Skënderbeu kishte të drejtë në raport me anëtarët e tjerë të lidhjes të thirrte kuvendin e princave shqiptarë sa herë ta shinte të nevojshme për interesat e mbrojtjes së vendit. Anëtarët e lidhjes ruanin të drejtën e largimit prej saj, kur ta shinte të nevojshme. Skënderbeu si kryetar i lidhjes dhe lidhja nuk kishin të drejtë ta pengonin ose të merrnin masa kundër tij.

Në Lidhje bujarët feudale ruajtën të drejtën të hynin në marrëdhënie ndërkombëtare në mënyrë të pavarur. Në vitet e mëvonshme një pjesë e mirë e princave shqiptarë përfunduan traktate ndërkombëtare me shtetet italianë, pavarësisht nga Skënderbeu dhe Lidhja. Gjergj Araniti lidhi traktat të veçantë me Alfonsin e Napolit (1451), dhe një tjetër me Venedikun. Kështu kanë vepruar edhe bujarët e tjerë.

Lufta e përbashkët kundër Perandorisë Osmane dhe Venedikut bëri që subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare në vendimet të dalë në tërësi "Lidhja e princave shqiptarë" dhe jo ndonjë bujar i veçantë. Gjatë luftës me Venedikun më 1448 Skënderbeu, pas vdekjes së Lekë Zaharisë, e kërkoi qytetin e Danjës në emër të Lidhjes. Fitorja u arrit me forca të përbashkëta të feudalëve shqiptarë. Kurse Traktati i Paqes (4 tetor 1448) u përfundua duke qenë palë "Lidhje e princave shqiptarë", e përfaqësuar nga Skënderbeu dhe Nikollë Dukagjini e Republika e Venedikut. Në historinë e Lidhjes së Lezhës ky është rasti i parë kur del në bllok njëkohësisht para dy armiqve të rrezikshëm, Perandorisë Osmane dhe Venedikut. Lidhja lufton dhe fiton për mbrojtjen e vendit dhe të tërësisë së tij territoriale, vepron me personalitet të plotë politik në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Mbështetja në popull, faktori kryesor i Lidhjes

Kuvendi i Lezhës dhe vendimet e marra në të patën rëndësi historike për fatet e luftës së madhe shqiptaro-osmane të shek. XV. Lidhja e Lezhës dhe kryekomandanti i saj, Skënderbeu, gëzonin mbështetjen e pakufishme të popullit. Në këto rrethana lufta mori tiparet e një lufte tipike popullore. Pikërisht, ky faktor i dha mundësi vendit tonë, që me mjete njerëzore e ekonomike relativisht të kufizuara, të përballonte sulmet e ushtrisë osmane, më e fuqishmja e kohës. Fitoret e luftërave dhe betejave që u zhvilluan për një çerek shekulli kundër hordhive të ushtrisë osmane, u mbështetën te shpirti liridashës i popullit, te vetitë e tij moralo-luftarake, te përvoja shekullore e luftërave të tij, si dhe tek aftësitë komanduese e gjenialiteti ushtarak i kryekomandantit Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Nga pikëpamja politike, Kuvendi i Lezhës ishte organi i vetëm në shkallë kombëtare brenda të cilit realizohej bashkimi i popullit shqiptar dhe i klasës feudale shqiptare në luftë

kundër pushtimit osman. Kuvendi i Lezhës me gjithë bazën feudale, dhe vendimet e marra shprehin objektivisht edhe interesat e popullit shqiptar, të cilat kërkonin më shumë se kushdo mbrojtje kundër pasojave të rënda që sillte pushtimi osman.

Kuvendi i Lezhës nga pikëpamja strategjike ishte organ kushtetues, që procedoi në krijimin e organeve të tilla me rëndësi të përgjithshme si "Lidhja e princave shqiptarë", komanda unike e ushtrisë nën udhëheqjen e Skënderbeut dhe fondet e përbashkëta për përballimin e luftës. Krijimi i organeve të përbashkëta kishte rëndësi të madhe. Shënonte kështu hapi i parë drejt forcimit të pushtetit qendror dhe daljen nga kuadri i ngushtë i copëtimit feudal. Në procesin e luftës së madhe shqiptaro-osmane, gjatë së cilës u realizua krijimi i shtetit. Ky shtet përfshinte një pjesë të mirë të territorit shqiptar: "Lidhja e princave shqiptarë" dhe organet që dolën nga Kuvendi i Lezhës pësuan ndryshime të rëndësishme, të cilat çuan në ndryshimin e natyrës së tyre politik-ushtarake.

Me krijimin e Lidhjes së Lezhës ishte bërë hapi i parë dhe shumë i rëndësishëm në rrugën e bashkimit. Në vitet e para të luftës ajo i dha një mbështetje të mirë Skënderbeut në përballimin e pushtimit osman dhe të politikës armiqësore të Venedikut. Me kalimin e viteve, në vetë gjirin e Lidhjes filluan të vepronin forca të tjera që e dobësonin unitetin e saj. Lidhja e Lezhës, u krijua si një aleancë politiko-ushtarake e bujarëve shqiptarë në luftën e përbashkët kundër pushtimit osman, ngrihej mbi bazën e copëtimit



feudal që nënkuptonte respektimin e sovranitetit dhe të privilegjeve të bujarëve të veçantë. Duke u mbështetur në këto privilegje, feudalët shqiptarë mbanin jashtë kuadrit të ushtrisë trupa që vepronin nën urdhrat e tyre. Ata shpesh herë nuk i përmbushnin detyrimet e ngarkuara nga Kuvendi i Lezhës për të ndihmuar me ushtarë dhe të holla. Kishte raste që largoheshin nga Lidhja, sikurse ishte Pjetër Spanit e Lekë Dushmanit më 1447 gjatë konfliktit me Venedikun e më vonë largimi i Dukagjinëve.

Qëndrimi i lëkundshëm i feudalëve shqiptarë nxitej e shfrytëzohej dhe nga osmanët e venedikasit. Këta duke përçarë bujarët shqiptarë, synonin të realizonin interesat e tyre. Në një vendim të Senatit të Venedikut, datë 10 tetor 1448, ku jepen udhëzime për provincën e tij në Shqipëri, theksohet se "Në qoftë se nuk vini në ujdë me Skënderbeun, vihuni në pjeqe me Pal e Nikollë Dukagjinin, t'u premtoni të holla, fshatra, etj... duke i ndarë nga Skënderbeu dhe duke i bashkuar me ne... sepse jemi të informuar se Skënderbeu pa Dukagjinët nuk është i zoti për të bërë gjë...". Lufta e madhe shqiptaro-osmane ishte një luftë totale. Ajo kërkonte bashkimin e të gjitha forcave, nëpërmjet forcimit

të pushtetit qendror. Interesat e larta të mbrojtjes së vendit diktonin nevojën e kapërcimit të copëzimit feudal dhe krijimin e shtetit shqiptar. Në realizimin e këtij procesi me rëndësi historike Skënderbeu u mbështet në përkrahjen e gjërë të popullit, i cili ishte i interesuar për zhvillimin dhe përfundimin e luftës me sukses; u mbështet në forcën e armatosur e të përhershme që kishte në dispozicion si komandant i përgjithshëm.

Ushtria shqiptare, e krijuar për nevojat e mbrojtjes së vendit, si në zotërimet e Kastriotëve, ashtu edhe të bujarëve të tjerë, ishte një mjet i fuqishëm dhe efektiv kundër partikularizmit feudal. Në zbatim të politikës së tij, Skënderbeu u mbështet sidomos te feudalët e vegjël, të cilët shërbenin si komandantë ushtrie dhe funksionarë politikë në shtetin e tij. Ata shihnin tek forcimi i pushteti qendror një mbrojtje efektive jo vetëm ndaj rrebeshit osman, por edhe ndaj kërcënimit të përhershëm të feudalëve më të fuqishëm. Për të lidhur sa më tepër klasën sunduese me luftën çlirimtare të popullit shqiptar, Skënderbeu, në emër të pushteti qendror, ndoqi politikën e shpërndarjes së pronimeve në dobi të bujarëve që kishte në shërbim ose pakësimin e tributeve që paguanin për shtetin. Përcaktoi kushtin që të merrnin pjesë personalisht në luftë, së bashku me një numër të caktuar ushtarësh. Të tilla pronia dhe bashkë ai i dha psh Vrana Kontit, Hamza Kastriotit, Moisi Golemit dhe bujarëve të tjerë.

Forcimi i pushtetit qendror nga Skënderbeu

M. Barleti vëren këtë akt politik të Skënderbeut dhe e pasqyron në faqet e veprës së tij. Ai shkruan: "Nuk duhet të çuditet kush këtu për një ngritje aq të menjëhershme dhe për shpejtësinë gati të pabesueshme të tanëve lidhur me mbledhjen e ushtarëve, sepse Skënderbeu, qoftë me dëshirë të vet... qoftë si shpërblim trimërie, u kishte falur disave prej parisë së vet një pjesë të madhe të taksave, sidomos pronave me kushtin që, kur të dilte nevoja për luftë, të ishin të detyruar në bazë të urdhërit të tij, të jepnin ndihma me ushtarë, secili sipas shkallës dhe të merrnin edhe vetë pjesë për gjithçka duhej bërë". Faktor me rëndësi në forcimin e pushtetit ishte prestigji dhe autoriteti i Skënderbeut në radhët e masave popullore dhe të vet bujarëve aleatë. Këtë Skënderbeu e përdori për rritjen e autoritetit të vetë organeve qendrore dhe të komandës së ushtrisë. Duhet shtuar dhe lidhjet e shumta martesore midis feudalëve më të fuqishëm të vendit dhe Kastriotëve, që kishin filluar qysh në kohën e Gjon Kastriotit dhe të vazhduara nga Skënderbeu për të siguruar një bashkim sa më të ngushtë të klasës feudale shqiptare.

Skënderbeu, për hir të interesave të larta të mbrojtjes së vendit, si përfaqësuesi i pushtetit qendror, filloi të shkelte sovranitetin e feudalëve të veçantë brenda principatave të tyre, duke i lënë atje jo si zotër të pavarur, por si qeveritarë të nënshtuar që vareshin drejtpërsëdrejti prej tij në kështjellat e tyre dhe shkelte kufijtë e zotërimeve të tyre gjatë veprimeve luftarake. Nevoja për të plotësuar radhët e ushtrisë me luftëtarë të rinj e detyronte të mobilizonte ushtarë me iniciativën e vet dhe në zotërimet e feudalëve të tjerë, etj. Këto veprime ishin, jo vetëm shkelje e sovranitetit të bujarëve aleatë, por edhe ushtrim itributeve të pushtetit në territore që nuk i përkisnin principatës së Kastriotëve. Në këtë mënyrë, pushteti i feudalëve të veçantë filloi gradualisht të mënjanohej e të dobësohej, krahas me forcimin e pushteti qendror të përfaqësuar nga

Skënderbeu. Zotërimet e tyre filluan të shkriheshin me principatën e Kastriotëve.

Duke pasqyruar këtë proces me rëndësi historike për fatet e luftës së madhe shqiptaro-osmane, bujari Gjon Muzaka shkruan në kujtimet e tij se Skënderbeu "pasi u bë kryekomandant i zotërinjëve të Shqipërisë... vendosi të shtinte në dorë gjithë vendin... Ai vuri në burg zotërinjtë Gjon dhe Gojko Balsha... dhe u mori shtetin e tyre që ishte midis Krujës dhe Lezhës; zotit Moisi Komneit i mori shtetin që ishte në Dibër... Dhe pasi vdiq im atë, na morri neve Tomorrihtën dmth, Myzeqenë e Vogël dhe po ashtu zotërve të tjerë... por ata s'kishin se ç'të bënin sepse ai tashmë kishte gjithë luftëtarët me vete dhe osmanët na rrinte për orë mbi shpinë...".

Gjon Muzaka e thotë haptazi se këto ishin masa dhune dhe se shpresat e Skënderbeut u rritën sidomos kur Papa Piu II shpalli kryqëzatën kundra osmanëve dhe i premtoi atij kurorën e Shqipërisë. Dëshmia e bujarit Gjon Muzaka, që ishte i pakënaqur nga kjo politikë e Skënderbeut, konfirmohet dhe plotësohet me diplomaci nga M. Barleti, i cili thotë se "kishte futur në mbretëri të tij me dëshirën e tyre të dy Dibrat", pra Dibrën e Sipërme dhe të Poshtëme. Përveç kësaj M. Barleti dëshmon se Skënderbeu "i shtiu dhe i zgjeroi kufitë e mbretërisë së vet më tepër se i ati, Gjoni" se në principatën e tij hyri "edhe Mokra e cila se kishte provuar kurrë sundimin e fisit të Kastriotëve".

Forcimi i pushtetit dhe krijimi i shtetit shqiptar ishte një proces që nuk u krye menjëherë. I filluar para vitit 1450, ai vazhdoi me ritme të shpejta gjatë viteve 1450-1460.



Rëndësi të veçantë pati në këtë drejtim fitorja e madhe që arriti populli shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut gjatë rrethimit të parë të Krujës (1450), e cila ia rriti më tej autoritetin Skënderbeut, si brenda dhe jashtë vendit. Gjatë kësaj prove të vështirë një pjesë e bujarëve aleatë u larguan nga Lidhja e Lezhës gjë që tregoi edhe një herë domosdoshmërinë e kapërcimit të copëtimit feudal si një rrezik serioz për fatet e luftës çlirimtare. Pas rrethimit të parë të Krujës, si pasojë e masave shtërnguese që mori Skënderbeu, jo vetëm feudalët e vegjël, por edhe të mëdhenjtë, si Muzakët, Topiajt, Balshajt e humbën gradualisht pozitën e tyre si zotër feudalë të pavarur dhe principatat e tyre u bashkuan me atë të Skënderbeut. Me gjithë përpjekjet e Skënderbeut, dy nga zotërimet feudale më të fuqishme të vendit, ai i Dukagjinëve në veri dhe i Gjergj Aranitit në jug, për një kohë të gjatë nuk u bashkuan me shtetin shqiptar, por qëndruan si principata feudale më vete.

Aranitët e konsideronin Skënderbeun vetëm si aleat, pa iu nënshtuar vullnetit të tij. Mirëpo, me vdekjen e Gjergj

Aranitit (vjuhërrit të Skënderbeut), ai mundi ta bashkonte këtë principatë të fuqishme me shtetin. Në vitin 1463 Skënderbeu përfundoi një marrëveshje armëpushimi me Perandorinë Osmane. Midis detyrimeve që merr pala shqiptare në këtë marrëveshje është dërgimi i njërit prej djemëve të Gjergj Aranitit në ushtrinë e Sulltanit sa herë të paraqitej nevoja. E pafuqishme për të kundërshtuar dhëndërrin e vet, e veja e Gjergj Aranitit, në datë 3 shtator 1463 shkoi pranë Senatit të Venedikut dhe kërkoi që ai të ndikonte te Skënderbeu për të mos e dërguar djalin e vet në ushtrinë e Sulltanit. Senati i Venedikut iu përgjigj se kjo gjë s'ka për të ndodhur, sepse "ndonëse i madhi zoti Skënderbeu bëri paqe me osmanët megjithatë, duhet shpresuar se do t'i rrokë armët kundër Sulltanit". Ky fakt tregon se Skënderbeu në këtë periudhë e kishte shtrirë pushtetin e vet mbi principatën e Aranitëve, deri sa i ngarkon sundimtarët e saj me detyrime pa marrë pëlqimin e tyre në mënyrë paraprake.

Dukagjinët në veri e ruajtën deri në fund pozitën e tyre si zotër të pavarur. Të nxitur nga Venediku ata për një kohë të gjatë mbajtën qëndrim armiqësor ndaj Skënderbeut dhe politikës së tij duke bashkëpunuar hera-herës me osmanët në dëm të çështjes së çlirimit. Në vitin 1463 Lekë Dukagjini iu drejtua Republikës së Venedikut me një sërë kërkesash dhe propozimesh. Midis të tjerash ai shpallte se "Nuk duhet të jem nën Skënderbeun, por jam fare i kënaqur të jem nën cilindo rektor e proveditor të asaj Sinjorine, e të qëndroj gjithmonë në urdhërat e saj. Gjithashtu kërkoi që në rast se Skënderbeu më shpall luftë, fort e ndritura Sinjori të më ndihmojë mua, gjithashtu në rast se i shpall unë atij, të ndihmojë atë kundër meje". Dhe Venediku i përgjigjet se "Ne jemi të kënaqur të përmbushim kërkesën e tij, dmth, që ai të mos jetë nën madhërueshmin Skënderbej, por nën provizorin tonë ose nën çdo rektor të atyre anëve". Përballë politikës shtërnguese të Skënderbeut një pjesë e feudalëve shqiptarë dolën nga Lidhja e Lezhës dhe filluan të kërkonin mbështetje te fuqitë e huaja, si Napoli dhe Venediku ose kaluan në tradhëti të hapur, si Hamza Kastrioti, Moisi Golemi, Gjergj Stres Balsha, etj. I mbështetur në përkrahjen popullore si dhe në ushtrinë që kishte në dispozicion, Skënderbeu mori masa energjike dhune kundër tradhëtisë feudale dhe burgosi fajtorët, pa kursyer në këtë mes edhe të afërmit e tij, si Hamza Kastriotin, Gjergj Stres Balsha e ndonjë tjetër. Masat që mori Skënderbeu në emër të pushtetit për shpartallimin e tradhëtisë feudale i shërbenin drejtpërsëdrejti forcimit të unitetit dhe të aftësisë mbrojtëse të vendit, bashkimit të mëtejshëm të tokave shqiptare në një shtet të vetëm. Me largimin e disa prej bujarëve shqiptarë nga Lidhja e Lezhës ajo e humbi karakterin dhe rëndësinë e mëparëshme si një aleancë politiko-ushtarake e feudalëve shqiptarë për mbrojtjen e zotëriomeve të tyre me forca të përbashkëta.

Principa e Kastriotëve organ qendror i shtetit shqiptar

Organet drejtuese të ushtrisë dhe të financave, që funksiononin në kuadrin e Lidhjes së Lezhës, u shkrinë me ato të principatës së Kastriotëve, duke marrë rëndësinë e organeve qendrore të shtetit shqiptar. Organet e administratës shtetërore të bujarëve të veçantë, vazhduan ushtrimin e funksioneve të tyre, por tashmë në vartësi të pushtetit qendror. Feudalët vasalë, që humbën pozitën e tyre si zotër më vete, u shndërruan në qeveritarë të pushtetit qendror dhe vareshin drejtpërdrejt nga Skënderbeu. Principatat e dikurshme feudale e humbën karakterin e tyre si formacione shtetërore më vete,

duke u shtrirë e njehësuar me shtetin shqiptar. Kufijtë e tyre të dikurshëm nuk ekzistonin më, në vend të tyre shteti shqiptar shtrihej nga brigjet e Adriatikut deri në Prizren dhe nga lumi Devoll e Seman në jug, duke përfshirë zotërimet e Aranitëve në Shqipërinë Qendrore deri në Dibër e Pollog.

Shteti i Skënderbeut nuk mundi të përfshinte brenda kufijve të vet të gjitha territoret ku flitej gjuha shqipe. Jashtë këtyre kufijve mbetën zonat e pushtuara nga osmanët, qytetet e pushtuara nga Venediku si dhe principata e Dukagjinëve në Veri. Nga pikëpamja territoriale bashkimi shtetëror i Shqipërisë nuk u arrit plotësisht. Megjithatë shteti i Skënderbeut ishte e përqëndruar për shkak të organizimit të brendshëm. U kalua nga qeverisja me vasalë, që ishte një formë e vjetëruar, tipike për periudhën e copëtimit feudal, në qeverisjen e vendit me funksionarë, që vepronin në emër dhe për llogari të pushtetit.

Shteti i Skënderbeut ishte një formë e sundimit politik të klasës feudale shqiptare. Lufta që zhvilloi Skënderbeu për forcimin e pushtetit dhe krijimin e shtetit shqiptar nuk ishte luftë kundër feudalizmit. Ajo ishte luftë kundër copëzimit dhe partikularizmit feudal, që dobësonte fuqinë mbrojtëse të vendit, pa prekur marrëdhëniet në prodhim, të cilat mbetën si edhe më parë, feudale. Shteti shqiptar, i themeluar dhe i udhëhequr për çerek shekulli nga Skënderbeu (1443-1468), e vazhdoi eksistencën e tij edhe pas vdekjes së Heroit Kombëtar, deri në vitin 1478, kur ra Kruja-kryeqyteti i tij dhe kështjella kryesore e mbrojtjes së vendit. Gjatë gjithë kësaj dekade, megjithëse me territore të cinguar gradualisht nga pushtuesit osmanë, ai vazhdoi të realizonte funksionet e tij kryesore në luftën e pabarabartë midis Shqipërisë së vogël dhe Perandorisë Osmane. Në shpalljen e Sulltan Mehmetit II kushtuar rënies së Krujës (1478), pasi përshkruhen mizoritë e pushtuesve ndaj mbrojtësve të saj, përcaktohen edhe synimet e tyre për shkatërrimin e organizimit politik dhe ushtarak të krijuar gjatë asaj epoke historike. "Thirrjet që nga kraharorët e tyre të dërmuar arritën gjer te tavani i Saturanit. Gjithsej rreth pesë mijë të pafe, që ishin secili një djall naftëhedhës dhe vetëtimë-lëshues, u bënë kështu pre e shpatës së mprehtë dhe e qokë e shigjetës goditëse... paskësaj do të fillojë shkatërrimi i kishave, ndërtimi i medreseve, ndalimi i kambonave dhe prishja e ligjeve". Krijimi i shtetit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut ishte një fitore e madhe historike e popullit shqiptar dhe përfundimi i atij procesi të ligjshëm për krijimin e formacioneve shtetërore të pavarura në mesjetë. Bashkimi i popullit shqiptar në një shtet të vetëm nën udhëheqjen e Skënderbeut ndihmoi në farkëtimin e unitetit politik të popullit onë në luftë kundër pushtuesve osman si dhe në konsolidimin e kombësisë shqiptare, mbi bazën e gjuhës, territorit dhe unitetit psikik-kulturor:

Literatura

- Lufta shqiptaro-turke në shek. XV (Burime osmane), përgatitur nga Selami Pulaha, Tiranë, 1968
- J. Radoniç, Gj. K. Skënderbeg i Arbanija u XV veku, Beograd, 1942, Dokumenti Nr. 259, Dt. 13 Dhjetor 1463.
- Gj. K. Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke e shek. XV, Tiranë, 1967.
- Dh. Qiriaz, botim shqip, Muzaka, memorie, përkthyer, Tiranë, 1996.
- K. Biçoku, Studime për epokën e Skënderbeut, vëll. 3, Tiranë, 1989.
- M. Barleti, Historia e Skënderbeut, Tiranë, 1967
- Fan S. Noli, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Tiranë, 1967.
- A. Buda, F. S. Noli, historian i Skënderbeut, parathënie për librin e F.S. Nolit Historia e Skënderbeut, Tiranë, 1967.
- A. Shahin Leka, Strateg e komandant legjendar, Skënderbeu, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë, 1994.



Ftesë nga Forcat e Armatosura

**Nisin orët e hapura
në shkollat e mesme**